



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 668 Akti

Nr. 792 Vendimi
Tiranë, më 4.9.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Alma Faskaj	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Albana Plaka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 2.9.2024, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Ornela Rrumbullaku**, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Alma Faskaj, analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe pasi shqyrtoi në seancën dëgjimore

publike në tërësi vlerësimin kalimtar ndaj subjektit, e cila kërkoi konfirmimin e saj në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë në datën e plotësimit të deklaratës së pasurisë, e cila aktualisht ushtron detyrën e prokurores në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 1651 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
3. Subjekti i rivlerësimit u shortua me shortin e datës 15.12.2020 dhe iu nënshtroa procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisioneret Xhensila Pine, Pamela Qirko dhe Alma Faskaj, ndërsa si vëzhgues ndërkombëtar u caktua z. Gerrit Sprenger.
4. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.12.2020, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, për të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, rivlerësimi i aftësive profesionale. Me mirëkuptim u caktua kryesuese e trupit gjykues komisionerja Pamela Qirko. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
5. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në rrugë elektronike¹ për përbërjen e trupit gjykues dhe iu kërkua deklarimi i konfliktit të interesit, për të cilin deklaroi se nuk ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.
6. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK); Grupi i Punës në Këshillin e Lartë të Prokurorisë (në vijim KLP).
7. Relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
8. AKSIK-ja (ish-DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti ka

¹ Subjekti u njoftua në datën 7.1.2021 me anë të postës elektronike (*email*).

kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

9. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar² raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, i deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 24.10.2023, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku.

10. Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumentet e tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm e të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

11. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, vendosi me vendimin nr. 2, datë 22.7.2024, përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, si dhe njoftimin për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

12. Subjekti i rivlerësimit u njoftua në datën 22.7.2024³ mbi rezultatet e hetimit, si dhe mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/sqarime shpeshë apo të kërkojë marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e përfutuara nga hetimi kryesisht zhvilluar nga Komisioni, duke i lënë afat deri në datën 15.8.2024.

13. Në datën 24.7.2024, subjekti i rivlerësimit u njoh me materialet e dosjes dhe kërkoi shtyrjen e afatit për dërgimin e shpjegimeve në lidhje me rezultatet e hetimit deri në datën 22.8.2024. Trupi gjykues, me qëllim garantimin e një procesi të rregullt ligjor, pranoi kërkesën e subjektit, duke zgjatur afatin e dërgimit të parashtrimeve.

14. Në datën 22.8.2024, brenda afatit të lënë nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit dërgoi me postë elektronike (*email*) shpjegimet dhe provat përkatëse.

15. Në datën 26.8.2024, me vendimin nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe me anë të postës elektronike e njoftoi se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 2.9.2024, në orën 11:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

16. Në datën 2.9.2024 u zhvillua seanca dëgjimore në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe parashtrori shpjegimet e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe me procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

II. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

17. Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur dhe duke dërguar dokumentacionin e shpjegimet përkatëse sipas kërkesës së Komisionit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve

² Me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 31.10.2023).

³ Komunikimet ndërmjet Komisionit dhe subjektit të rivlerësimit janë bërë në rrugë elektronike, me *email*.

dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

18. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

19. Referuar vendimit nr. 2/2017⁴ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

20. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuara pranë Komisionit nga AKSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale, dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

21. ILDKPKI-ja⁵, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, e cila është subjekt deklarues pranë këtij institucioni pa ndërprerje nga viti 2006, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*

⁴ 41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

⁵ Raporti nr. *** prot., datë 1.6.2020, i ILDKPKI-së.

- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

22. Pas analizimit të raportit dhe dosjes së dërguar nga ILDKPKI-ja, si dhe informacionet e marra nga subjekte të së drejtës publike, bazuar në nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, subjektit të rivlerësimit i janë njoftuar rezultatet e hetimit mbi asetet e deklaruara prej saj në deklaratën e pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, si vijon:

A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

23. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2006 – 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; (e) deklarimet në seancë dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

24. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet e informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

25. Në deklaratën *Vetting*, të dorëzuar në ILDKPKI në datën 28.1.2017, pas verifikimit administrativ të kryer nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri dhe likuiditete:

26. Automjet tip “Opel”, viti prodhimi 1997, me targë *.** Burimi i krijimit: Pjesërisht kursime, si dhe kredi konsumatore në Banka Kombëtare Tregtare sh.a., në shumën 300,000 lekë, disbursuar në datën 23.4.2007. Kredia e shlyer, numri i llogarisë është mbyllur. Vlera: 500,000 lekë. Pjesa takuese: 100%⁶.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

26.1 Nga hetimi rezultoi se për herë të parë kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën e vitit 2007 dhe në deklaratën e vitit 2017 janë deklaruar të ardhurat (e pritshme) nga shitja e saj.

26.2 DPSHTRR-ja⁷ konfirmoi blerjen e automjetit tip “Opel Astra” nga subjekti i rivlerësimit me kontratë shitblerjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.4.2007, nga shtetasi N.GJ dhe shitja e tij me kontratën nr. *** kol., nr. *** rep., datë 27.12.2017, në vlerën 1,200 euro, shtetasit E.M.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës në aneksin nr. *** dokumentacion justifikues.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2021.

26.3 Nga hetimi i Komisionit⁸ për konfliktin e interesit të subjektit për shkak të detyrës, me shtetasit e sipërpërmendur, nuk rezultuan indicie për materiale kallëzuese apo procedime penale të ndjekura nga subjekti në lidhje me këta shtetas.

26.4 Në lidhje me burimin e ligjshëm, subjekti ka deklaruar në *Vetting* si burim krijimi:

a) kredi konsumatore në Bankën Kombëtare Tregtare sh.a. në shumën 300,000 lekë, disbursuar në datën 23.4.2007. BKT-ja⁹ ka konfirmuar disbursimin e kredisë datë 23.4.2007, në shumën 296,000 lekë dhe tërheqjen e saj nga subjekti brenda datës 23.4.2007.

b) pjesërisht kursimet e subjektit të rivlerësimit, përkatësisht në vlerën 204,000 lekë.

Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga subjekti në DIPP-në e vitit 2007, deklarohen të ardhurat nga paga në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë në shumën 844,617 lekë, të cilat u konfirmuan nga vërtetimet e institucioneve bashkëlidhur deklaratës *Vetting*¹⁰ dhe nga *statement*-i i llogarisë së subjektit në Raiffeisen Bank¹¹, ku transferohen prej datës 25.4.2005 të ardhurat nga bursa dhe, më pas, të ardhurat nga paga e saj. Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit për periudhën janar 2007 deri në datën e blerjes së automjetit (datë 23.4.2007), nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur mundësi ta krijojë pasurinë me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i trupit gjykues

26.5 Komisioni, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit, çmon se për këtë pasuri nuk rezultuan problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

27. Apartament në rrugën “**”, Tiranë**, me numër pasurie ***, z. k. ***, sip. neto 85 m², blerë me kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2011. Apartamenti është i regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., me NIPT ***, me seli në M, njësia administrative F dhe është kolateral për kredinë e marrë për blerje apartamenti në Tirana Bank sh.a. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga personi fizik “****”, me NIPT ***. Bilanci i personit fizik është paraqitur në bankë për marrje kredie. Kredi nga Tirana Bank sh.a. në shumën 46,000 euro. Vlera: 77,350 euro. Pjesa takuese: 50%¹².

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

27.1 Subjekti ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 blerjen e apartamentit në rrugën “****”, në vlerën 77,350 euro, në bashkëpronësi me shtetasin A.M, i cili e ka shlyer shumën 30,940 euro me të ardhurat e tij. Bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 apartamentin e ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, me vlerë totale 76,940 euro. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar në vitin 2011 marrjen e kredisë hipotekore në Bankën e Tiranës sh.a. në shumën 46,000 euro, me bashkëkredimarrës z. A.M.

27.2 Komisioni konstaton se bashkëjetuesi ka deklaruar për herë të parë pranë ILDKPKI-së në vitin 2014 dhe jo në momentin e parashikuar në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin

⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. ***, datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 9.4.2021.

¹⁰ Aneks ***, dosja e ILDKPKI-së.

¹¹ Shkresë e Raiffeisen Bank nr. ***, datë 12.3.2021.

¹² Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës në aneksin nr. *** dokumentet justifikuese për pasurinë.

dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar¹³.

27.3 Nga hetimi konstatohet se bashkëjetuesi ka deklaruar vlerë të pasaktë për apartamentin në DIPP-në e vitit 2014, ku deklaroi vlerën 76,940 euro, ndërsa në kontratën e shitjes dhe deklaraten *Vetting* vlera e blerjes rezultoi 77,350 euro.

27.4 ASHK-ja¹⁴ konfirmoi blerjen e apartamentit me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 85 m², i regjistruar në datën 21.10.2010 me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.4.2017, me palë shitëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë blerëse shtetasit A.M dhe Ornela Rrumbullaku, ku deklarohet se blerësi e ka likuiduar totalisht shitësin me nënshkrimin e kontratës së sipërmarrjes. Gjithashtu, në kontratën e sipërmarrjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 1.11.2011, bashkëlidhur rezultoi se blerësit A.M dhe Ornela Rrumbullaku kanë rënë dakord të blejnë apartamentin me çmim total 77,350 euro.

27.5 Për mënyrën e shlyerjes së çmimit të apartamentit, bashkëlidhet kopje e mandatarkëtimit të shoqërisë “****” sh.p.k., nr. ***, datë 3.2.2011, ku rezulton se shtetasi A.M e ka paguar shumën 32,000 euro si parapagim për blerje apartamenti. Ndërsa Tirana Bank¹⁵ konfirmoi disbursimin e kredisë në shumën 46,000 euro në datën 9.3.2011 sipas kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2011 (notere E.K), për blerje apartamenti me sip. 85 m². Në datën 10.3.2011 është transferuar shuma 44,000 euro nga llogaria e shtetasit A.M në Tirana Bank me përshkrimin “Transfertë për Alfa Bank, përfitues ****sh.p.k. Tiranë. Pagesë për blerje shtëpie sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.1.2011”.

Shitja e apartamentit

27.6 Në deklarimin periodik vjetor 2017, subjekti deklaroi shitjen e apartamentit me sip. 85 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, rruga “****”, sipas kontratës së shitjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2017, para noterit A.H, në vlerën 78,000 euro. Vlera e shitjes së tij ka shërbyer për pagimin e disa kësteve për prenotimin e një apartamenti në ndërtim me shoqërinë “****” sh.p.k. në vitin 2017¹⁶. ASHK-ja¹⁷ konfirmoi se kjo pasuri rezultoi ende e regjistruar në emër të shtetasve A.M dhe Ornela Rrumbullaku, por e pacertifikuar.

27.7 Nga komunikimi¹⁸ me noterin A.H u konfirmua kontrata e shitblerjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2017, me palë shitëse shtetasit A.M dhe Ornela Rrumbullaku, palë blerëse shtetasin B.K, të apartamentit me sip. 85m², me numër pasurie nr. ***, z. k. *** e adresë rruga “****”, Tiranë, regjistruar në pronësi të palëve shitëse, me çmim shitjeje 78,000 euro. Gjithashtu, ISP Bank¹⁹ konfirmoi transferimin e vlerës 5,998,500 lekë (rreth 45,118 euro²⁰) nga llogaria e A.H

¹³ Ligji nr. 85/2012 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, neni 3 “Subjektet që mbartin detyrimin për deklarim pika gj), interesa private të subjektit, që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës”;

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 19.3.2021.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 2.3.2011.

¹⁶ Kontratë për prenotim apartamenti me “****” sh.p.k., nr. *** rep., nr. ***1829 kol., datë 14.11.2017. Notere A.M. Vlera totale e apartamentit: 52,249 euro. Është në ndërtim, nuk ka dokument pronësie. Paguar kësti i parë 30,000 euro, pa shlyer kësti i dytë 22,249 euro. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: Paguar kësti i parë nga të ardhurat nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2017, noter A.H.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 20.11.2023.

¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 30.10.2023.

¹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 25.3.2021.

²⁰ BOA kursi mesatar 2017 lekë/euro = 132,95.

person fizik në datën 16.10.2017, me përshkrimin “Pagesë sipas kontratës nr. *** rep., *** kol., kësti i parë.” Ndërsa nga *statement*-i bankar rezultoi edhe veprimi i kreditimit të shumës 33,000 euro, datë 13.11.2017, nga noteri A.H në llogari të subjektit Ornella Rrumbullaku me përshkrimin “Kalim kësti i dytë përfundimtar për shitblerje shtëpie sipas kontratë nr. *** rep., *** kol.”.

27.8 FSHU-ja²¹ dhe UKT-ja²² nuk konfirmuan kontratë furnizimi në instancën Tiranë të lidhur me shtetasit Ornella Rrumbullaku dhe A.M. Në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja²³ në datën 30.3.2016, subjekti përcjell kopje të librezës së OSHEE-së, të cilat janë regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k. me pagesat e kryera në periudhën shtator 2011 – dhjetor 2015.

27.9 Komisioni hetoi²⁴ konfliktin e interesit të subjektit gjatë kohës së ushtrimit të detyrës me shtetasit e sipërpërmendur, nga i cili nuk rezultuan indicie për materiale kallëzuese apo procedime penale të ndjekura nga subjekti në lidhje me këta shtetas.

27.10 Gjithashtu, Komisioni analizoi çmimin e blerjes së apartamentit me çmimin e referencës së EKB-së²⁵ për vitin 2011, nga ku rezultoi se vlera e blerjes së apartamentin nga subjekti në shumën 77,350 euro ose rreth 10,697,505 lekë është më e madhe se vlera e referencës prej 8,075,000 lekë (85 m² x 95,000 lekë/m²) ose 0,25 herë më shumë se referenca e tregut.

Lidhur me burimin e ligjshëm;

27.11 Subjekti ka deklaruar si burim: a) kredi nga Tirana Bank sh.a. në shumën 46,000 euro; b) të ardhurat nga personi fizik “****”, me NIPT ***. Bilanci i personit fizik është paraqitur në bankë për marrje kredie.

Nga komunikimi me Bashkinë Tiranë²⁶ dhe DRT-në²⁷ Tiranë u konfirmua se shtetasi A.M ka qenë i regjistruar në datën 11.2.2008 me aktivitet avokat, me NIPT ***, me datë çregjistrimi 31.5.2009, me xhiro të deklaruar të parashikuar 2-3 milionë lekë në vit. Për vitin 2008 vërtetohet se të ardhurat e deklaruara janë 6,275,796 lekë dhe fitimi neto 4,214,921 lekë.

27.12 Komisioni hartoi analizën financiare për pagesën e këstit të parë të shlyer prej bashkëjetuesit, duke u mbështetur në analizën e të ardhurave totale të përfituara nga bashkëjetuesi përpara fillimit të bashkëjetesës, gjatë periudhës 2001 – shkurt 2011, nga ku rezultoi se bashkëjetuesi kishte pamundësi financiare në vlerën - 618,831 lekë. Ndërsa në lidhje me pagesën e këstit të dytë rezultoi nga hetimi se si burim ka shërbyer kredia bankare e marrë pranë Tirana Bank dhe transferuar në llogarinë e shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k.

27.13 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me pamundësinë financiare të rezultuar nga hetimi për pagesën e këstit të parë të apartamentit nga personi i lidhur, në vlerën -618,831 lekë.

27.14 Subjekti pas kalimit të barrës së provës shpjegon se Komisioni nuk ka përllogaritur të ardhurat nga institucioni i T. K, ku bashkëjetuesi ka qenë i punësuar në periudhën shtator 2006 – shtator 2007. Në këtë pikë ka një lapsus, pasi institucioni i Teatrit të ***, *** dhe ***, ku

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 11.3.2021.

²² Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2021.

²³ Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2021.

²⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. ***, datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

²⁵ Udhëzim nr. 4, datë 23.11.2011, për vitin 2011, zona ***, çmimi i shitjes në tregun e lirë të apartamenteve është 95,000 lekë/m² për sipërfaqe të shfrytëzueshme.

²⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 7.7.2017, aneks ***.

²⁷ Shkresë përcjellë nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *Vetting* nr. *** prot., datë 27.10.2016 (aneks ***).

bashkëjetuesi ka qenë i punësuar në periudhën 2001 – 2005, është i ndryshëm nga Teatri ***, institucion ku ka qenë i punësuar në periudhën shtator 2006 – shtator 2007. Të ardhurat e pranuar nga Komisioni janë: (a) nga Teatri K. i ***, *** dhe ***: 732,215 lekë, konfirmuar nga Komisioni; (b) nga Teatri ***: 721,168 lekë, konfirmuar nga Komisioni (por të pallogaritura).

Vlerësimi i trupit gjykues

27.15 Komisioni çmoi se analiza financiare për pagesën e kështit të parë për blerjen e apartamentit prej bashkëjetuesit duhet të rishikohet, duke u përfshirë edhe të ardhurat e përfituara prej tij nga Teatri ***, në vlerën 721,168 lekë, të cilat gjatë hetimit janë konfirmuar nga institucionet. Në analizën financiare të rishikuar, pas shtimit të vlerës së të ardhurave nga Teatri ***, rezultoi se bashkëjetuesi kishte mundësi të kryente pagesën e kështit të parë me të ardhura të ligjshme. Në përfundim, trupi gjykues, në analizë të provave dhe fakteve të administruara gjatë hetimit dhe deklaramëve të subjektit në seancë dëgjimore, çmon se për këtë pasuri nuk rezultuan problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

28. Numër llogarie * në Raiffeisen Bank sh.a.** Vlera: 927.24 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

28.1 Nga hetimi i Komisionit²⁸ u konfirmua se subjekti ka çelur në datën 25.4.2005 llogari page me gjendje në datën 31.12.2016 në vlerën 0 lekë, në të cilën janë transferuar fillimisht shumat e përfituara nga bursat dhe më pas të ardhurat nga paga.

Vlerësimi i trupit gjykues

28.2 Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë e në përputhje me dokumentacionin bankar, duke mos konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri në kuptim të procesit të rivlerësimit.

29. Numër llogarie * pranë Union Bank sh. a.** Vlera: 159.45 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

29.1 Union Bank²⁹ konfirmoi llogari bashkëmërore të subjektit dhe bashkëjetuesit, z. A.M, të hapur në datën 17.9.2010. Kjo llogari është përdorur kryesisht për depozitimin e shumave nga subjekti me qëllim pagesat e kësteve të kredisë konsumatore (datë 21.9.2010) të marrë prej saj. Më pas është përdorur për transferimin e pagave nga F. Sh. e F për z. A.M. Në datën 31.12.2016, gjendja e llogarisë ka qenë 253.31 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

29.2 Sa më lart, trupi gjykues çmon se nuk u konstatuan problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

30. Numër llogarie * pranë Union Bank sh.a.** (kartë krediti me limit 500 euro). Vlera: 7,17 euro. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

²⁸ Shkresë e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 12.3.2021.

²⁹ Shkresë e Union Bank nr. *** prot., datë 9.3.2021.

30.1 Union Bank³⁰ konfirmoi llogarinë rrjedhëse të kartës së kreditit të hapur në datën 17.9.2012, e cila është përdorur nga subjekti kryesisht për blerje online dhe jashtë vendit. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë 7,17 euro.

Vlerësimi i trupit gjykues

30.2 Në përfundim, trupi gjykues çmoi se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari dhe përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e përcjellë.

31. Numër llogarie * pranë Tirana Bank sh.a.** Vlera: 15,97 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

31.1 Nga hetimi³¹ rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka llogari personale pranë Tirana Bank, porse është bashkëkredimarrëse me shtetasin A.M, i cili është titullari i llogarisë së deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting*. Kjo llogari është çelur në monedhën euro dhe jo siç është deklaruar prej subjektit, në monedhën lek. Llogaria bankare është hapur nga bashkëjetuesi në datën 14.5.2008 dhe është përdorur prej tij për pagesa të ndryshme nga/drejt individëve dhe shoqërive tregtare për transaksione të lidhura me aktivitetin e tij. Ndërsa prej datës 9.3.2011 është përdorur për depozitim të shumave për pagesat e kredisë së përfituar pranë Tirana Bank, me qëllim blerjen e apartamentit të trajtuar më lart. Gjendja e kësaj llogarie në datën 31.12.2016 ka qenë 28,14 euro.

Vlerësimi i trupit gjykues

31.2 Në përfundim, rezulton se nuk u konstatuan problematika në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

32. Kredi për blerje apartamenti në rrugën “**”,** Tiranë, principali 46,000 euro, interes i aplikuar 7.3%, kohëzgjatje 25 vjet, kështu mujor 334,28 euro. Filluar në mars 2011, mbaron në mars 2036. Bashkëlidhur kontratë kredie nr. *** rep., *** kol., datë 7.3.2011, notere E.K, shtojcë kontrate kredie hipotekore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.5.2013, notere E.K. Kontratë hipotekore, nënshkruar mes shoqërisë “****” sh.p.k. dhe Tirana Bank sh.a. nr. *** kol., nr. *** kol., datë 7.3.2011, notere E.K. Vërtetimi i pronësisë, pjesë e kontratës së hipotekimit. Detyrimi i mbetur: 41,606 euro. Trajtimi i kredisë bankare është bërë më lart, tek pasuria “Apartament në rrugën “****”, Tiranë”.

33. Overdraft i çelur pranë Raiffeisen Bank sh.a. në nr. e llogarisë *** sipas “kontratës së kredisë me kufi”, datë 17.1.2017. Nuk është tërhequr asnjë vlerë dhe nuk ka asnjë detyrim për të paguar në datën e dorëzimit të kësaj deklarate. Interesi mbi balancën debitore të llogarisë rrjedhëse është Tribor 1-vjeçar + 10.1 %. Norma efektive e interesit në momentin e nënshkrimit të kontratës është 13.55% në vit. Shuma e detyrimit: 0 lekë.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

33.1 Raiffeisen Bank³² konfirmoi shumën e *overdraft*-it prej 100,000 lekësh, e cila është përfituar me kontratën e lidhur në datën 17.1.2017. Subjekti bashkëlidh me deklaratën *Vetting* (aneks ***) kontratën e kredisë.

Vlerësimi i trupit gjykues

³⁰ Shkresë e Union Bank nr. *** prot., datë 9.3.2021.

³¹ Shkresë e Tirana Bank nr. *** prot., datë 2.3.2021.

³² Shkresë e Raiffeisen Bank nr. *** prot., datë 12.3.2021.

33.2 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga institucioni.

34. Kartë krediti pranë “Union Bank” sh.a. me limit përdorimi 500 euro, në numrin e llogarisë ***. Në datën e deklarimit nuk ka asnjë detyrim për të shlyer.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

34.1 Union Bank³³ konfirmoi se llogaria me nr. *** është llogaria rrjedhëse e subjektit dhe bashkëjetuesit, e cila është trajtuar më lart në këtë vendim dhe nuk rezultoi të jetë e lidhur me kartën e saj të kreditit.

Vlerësimi i trupit gjykues

34.2 Sa më lart, trupi gjykues çmon se nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Deklarimi i pasurive nga personi i lidhur në deklaratën Vetting

35. Tokë arë me sipërfaqe totale 16.900 m² (nr. pasurie ***, me sip. 12,430 m²; nr. pasurie *** me sip. 600 m², nga të cilat 200 m² truall dhe ndërtim 93 m²; nr. pasurie ***, me sip. 3,600 m²). Pasuria ndodhet në B, Lushnjë. Burimi i krijimit: Ligji nr. 7501/1991. Për shkak të familjes bujqësore, në bashkëpronësi ideale me familjen bujqësore, me kryefamiljare shtetasen V.M, detyrimet janë paguar. Vlera: Pasuria është përfituar pa pagesë nga shteti, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 dhe trashëgimi nga babai. Pjesa takuese: 30%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

35.1 Rezultoi se për herë të parë kjo pasuri është deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 nga shtetasia A.M në cilësinë e personit të lidhur (bashkëjetuesit).

35.2 Subjekti ka depozituar bashkëlidhur deklaratës Vetting³⁴ certifikatë për vërtetim pronësie të datës 22.1.2016, nga e cila rezultoi se në emër të shtetasës V.M si përfaqësuese e familjes është regjistruar pasuria arë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, fq. ***, me sip. 12,430 m², në B, Lushnjë. Ndërsa bashkëlidhur procesverbalit të mbajtur nga ILDKPKI-ja³⁵ në mars 2016 është përcjellë certifikata e pronësisë e lëshuar në datën 23.5.2007 për pasurinë arë me nr. ***, z. k. ***, me sip. 12,700 m², e regjistruar në emër të shtetasit U.M.

35.3 Gjithashtu, subjekti bashkëlidh kopje të certifikatës për vërtetim pronësie, e lëshuar në datën 23.5.2007 për pasurinë arë + truall, me nr. pasurie nr. ***, me sipërfaqe totale 600 m², nga kjo 200 m² truall dhe 96 m² ndërtesë. Pasuria rezultoi e regjistruar në emër të shtetasit U.M si përfaqësues i familjes.

35.4 Përcillet me deklaratën Vetting edhe kopje e certifikatës për vërtetim pronësie, e lëshuar në datën 23.5.2007 për pasurinë nr. ***, të llojit arë, me sipërfaqe totale 3,600 m², të regjistruar në emër të shtetasit U.M si përfaqësues i familjes.

35.5 Nga kopja e certifikatës familjare të gjendjes civile, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë, e lëshuar në datën 1.10.1992, u konfirmua përbërja familjare me kryefamiljar z. U.M etj. Ndërsa

³³ Shkresë e Union Bank nr. *** prot., datë 9.3.2021.

³⁴ Aneks nr. ***, dosja ILDKPKI.

³⁵ Shkresë e ILDKPKI-së nr. *** prot., datë 5.3.2021.

nga kopja e AMTP-së nr.***, datë 15.6.1999, familjes së shtetasit U.M, në bazë të ligjit për tokën nr. 7501/1991, i është dhënë në pronësi tokë arë (16,630 m² në pronësi dhe 370 m² në përdorim) dhe truall (200 m²) në përdorim.

35.6 Me dëshminë e trashëgimisë datë 28.9.2015 (me kërkuese shtetasen M.M, vajza e të ndjerit U.M) është vendosur lëshimi i trashëgimisë për trashëgimtarët ligjorë të radhës së parë: V.M (bashkëshortja), M.M (e bija), A.M (i biri), E.M (i biri) dhe G.M (i biri), të cilët trashëgojnë secili 1/5 pjesë të pasurisë trashëgimore.

35.7 ASHK-ja³⁶ nuk konfirmoi regjistrimin e pasurive sa më sipër dhe konfirmoi se nuk ka praktika për legalizim leje për ndërtim të paligjshëm për personat e lidhur dhe të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

35.8 Sa më lart, trupi gjykues çmon se këto pasuri janë krijuar para fillimit të bashkëjetesës së subjektit me personin e lidhur, z. A.M dhe rezultoi se pasuritë janë përfituar nga ligji nr. 7501/1991 “Për tokën” si familje bujqësore në fshatin B, Lushnjë. Nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

36. Automjet “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2001, me targë *. Kontratë blerjeje nr. *** rep., *** kol., datë 7.3.2010, notere M.D. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia para bashkëjetesës. Vlera: 10,000 euro. Pjesa takuese: 100%.**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

36.1 Nga hetimi rezultoi se pasuria është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2014 nga personi i lidhur.

36.2 DPSHTRR-ja³⁷ konfirmoi se shtetasi A.M ka në pronësi automjetin me targë ***. Gjithashtu përcillet bashkëlidhur edhe kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 7.3.2010, me palë blerëse shtetasin A.M – person fizik me NIPT *** dhe palë shitëse shtetasin A.TH në vlerën 10,000 euro, për automjetin tip “Volkswagen” me targë ***.

36.3 Komisioni hetoi³⁸ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasin e sipërpërmendur, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këtë shtetas.

36.4 Lidhur me burimin e ligjshëm, Komisioni hartoi analizën financiare me të ardhurat e bashkëjetuesit për periudhën 2001 – 7.3.2010, nga ku rezultoi se bashkëjetuesi ka pasur mundësi për të krijuar vlerën e blerjes së automjetit me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i trupit gjykues

36.5 Sa më lart, trupi gjykues çmon se kjo pasuri është krijuar para fillimit të bashkëjetesës së subjektit me personin e lidhur, z. A.M dhe nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

³⁶ Shkresë nr. ***, datë 10.5.2021.

³⁷ Aneks ***, shkresë nr. *** prot., datë 10.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 29.5.2024.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. *** datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

37. Personi fizik “*”, me NIPT ***, me status “Pezulluar” në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.** Janë paguar të gjitha detyrimet dhe do të çregjistrohet. Nuk ka vlerë.

Gjithashtu, personi i lidhur ka deklaruar në seksionin e të ardhurave, në deklaratën *Vetting*, të ardhurat nga ky aktivitet në vitin 2010 dhe gjatë viteve 2014 – 2016.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

37.1 Personi i lidhur deklaron për herë të parë të ardhurat nga ky aktivitet në DIPP-në e vitit 2014, në vlerën 840,386 lekë.

37.2 QKB-ja dhe DPT-ja³⁹ informuan se shtetasi A.M rezultoi i regjistruar në organin tatimor si person fizik me NIPT ***, me datë regjistrimi 18.1.2010, me objekt “Aktivitete të drejtësisë” dhe aktualisht i çregjistruar (datë 10.1.2018). Bashkëlidhur përcillen deklaratat e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2010 dhe vitet 2014 – 2016.

Tabela nr. 1

Vitet	2010	2011	2013	2014	2015	2016
Të ardhurat e deklaruara	1,989,297	0	0	1,176,944	750,000	1,404,956
Fitimi neto/humbje	305,213	(-28,500)	0	840,386 ⁴⁰	517,000 ⁴¹	1,296,296
Deklarimi në <i>Vetting</i> nga personi i lidhur i të ardhurave neto	<u>274,692</u>			<u>840,386</u>	<u>517,000</u>	<u>1,295,596</u>

Vlerësimi i trupit gjykues

37.3 Komisioni vlerëson se në analizën financiare duhet të përfshihet si e ardhur nga ky aktivitet fitimi neto i konfirmuar nga institucionet, paraqitur në tabelën më lart. Në vitet 2010 dhe 2016, në të cilat ka mospërputhje me deklarinimin, është përfshirë në analizë vlera e deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën *Vetting*.

38. Numër llogarie * në Union Bank.** Vlera: 159.45 lekë. Pjesa takuese: 50%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

38.1 Union Bank⁴² konfirmoi llogari me gjendje 159,45 lekë në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting*. Gjithashtu, ashtu si trajtuar më lart në këtë vendim, kjo është llogari bashkëmërore e subjektit dhe e bashkëjetuesit të saj.

Vlerësimi i trupit gjykues

38.2 Komisioni çmon se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

39. Numër llogarie * në Bankën Kombëtare Tregtare sh.a.** Vlera: 803 lekë.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.3.2021, shkresat-komunikimet me Tatimet, të ndodhura në anekset ***, dosja e ILDKPKI-së.

⁴⁰ Këtu zbritet vlera e tatimit fiks pas fitimit prej 25,000 lekësh.

⁴¹ Këtu zbritet vlera e tatimit fiks pas fitimit prej 25,000 lekësh.

⁴² Shkresë e Union Bank nr. ***, datë 9.3.2021.

39.1 BKT-ja⁴³ konfirmoi se në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* gjendja e llogarisë ka qenë në vlerën 803 lekë. Kjo është llogari e çelur në datën 15.4.2016 dhe deri në datën e deklarimit është përdorur kryesisht për transferimin e pagës nga Bashkia V etj.

Vlerësimi i trupit gjykues

39.2 Komisioni çmon se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

40. Numër llogarie * në euro, në Raiffeisen Bank sh.a.** Vlera: 21,07 euro (personi fizik “***”). Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

40.1 Raiffeisen Bank⁴⁴ konfirmoi llogarinë e mësipërme në monedhën euro, çelur në datën 21.4.2014. Kjo është llogari e personit fizik, e përdorur prej tij për aktivitetin juridik vetjak.

Vlerësimi i trupit gjykues

40.2 Komisioni çmon se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

41. Numër llogarie * në “Raiffeisen Bank” sh.a.** Vlera: 4,427 lekë (personi fizik “***”). Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

41.1 Raiffeisen Bank⁴⁵ konfirmoi llogari page me gjendje në datën 26.1.2017 shumën 916 lekë. Kjo është llogari e personit fizik e përdorur prej tij për aktivitetin juridik.

Vlerësimi i trupit gjykues

41.2 Komisioni çmon se përputhet deklarimi i subjektit të rivlerësimit me dokumentacionin e përcjellë.

42. Numër llogarie * lekë në “Raiffeisen Bank” sh.a.** (individ). Vlera: 916 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

42.1 Raiffeisen Bank⁴⁶ konfirmoi se kjo llogari page e personit të lidhur është çelur në datën 3.10.2006 dhe gjendja e saj në datën 26.1.2017 është 916 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

42.2 Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e përcjellë dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

43. Numër llogarie * lekë në “Raiffeisen Bank” sh.a.** Vlera: 4.44 euro.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

⁴³ Shkresë e BKT nr. ***, datë 9.4.2021.

⁴⁴ Shkresë e RBAL nr. ***, datë 12.3.2021.

⁴⁵ Shkresë e RBAL nr. ***, datë 12.3.2021.

⁴⁶ Shkresë e RBAL nr. ***, datë 12.3.2021.

43.1 Raiffeisen Bank⁴⁷ konfirmoi llogari me gjendje në datën 26.1.2017 shumën 4.44 euro. Kjo llogari është çelur në datën 29.1.2014 dhe ka shërbyer për pagesa, të cilat i janë bërë si person fizik shtetasit A.M dhe për pagesat e kartës së kreditit.

Vlerësimi i trupit gjykues

43.2 Komisioni çmon se përputhet deklarimi me dokumentacionin e përcjellë dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

44. Numër llogarie * lekë në “Credins Bank”.** Vlera: 15.72 lekë.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

44.1 Credins Bank⁴⁸ konfirmoi llogari me gjendje në datën 26.1.2017 shumën 15.27 lekë. Kjo llogari është çelur në datën 9.9.2009 dhe ka shërbyer për pagesa në lidhje me aktivitetin e avokatisë.

Vlerësimi i trupit gjykues

44.2 Komisioni çmon se përputhet deklarimi me dokumentacionin e përcjellë dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë llogari në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

45. Kuota në shoqërinë “**” sh.p.k. me NIPT ***.** *Shoqëria nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar dhe është me status “Pezulluar”, do të çregjistrohet. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia; Kam blerë 50% të pjesëmarrjes në shumën 50,000 lekë dhe kam shitur 15% të pjesëmarrjes në shumën 15,000 lekë (bashkëlidhur kontratat). Vlera: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 35%.*

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

45.1 Personi i lidhur deklaron në DIPP-në e vitit 2015 blerjen e aksioneve në shoqërinë “****” sh.p.k. shitjen e 15% të kapitalit të saj.

45.2 QKB-ja⁴⁹ konfirmoi se shtetasi A.M ka qenë administrator nga data 23.3.2015 deri në datën 23.3.2020 dhe ortak me zotërim 35% të kuotave⁵⁰ në shoqërinë “****” sh.p.k., e regjistruar në datën 10.12.2014, me NIPT *** dhe me vlerë të kapitalit të regjistruar prej 100,000 lekësh. Objekti i veprimtarisë është “të japë konsulencë në fushën e mjedisit, etj.”, me status “Pezulluar”. Prej kontratës së përcjellë nga institucionet rezultoi se shtetasi A.M ka blerë 50% të aksioneve me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 16.2.2015, nga shtetasi J.S, me çmim total prej 50,000 lekësh. Ndërsa me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 26.3.2015, i janë shitur 15% të aksioneve të zotëruara nga shtetasi M shtetases M.M me vlerë shitjeje 15,000 lekë. DPT-ja⁵¹ konfirmoi se ky subjekt tregtar nuk ka deklaruar të ardhura apo fitim gjatë periudhës 2014 – 2015.

45.3 Komisioni hetoi⁵² nëse ekzistonte konflikti i interesit i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit e sipërpërmendur, nga i cili nuk rezultuan indicie që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këta shtetas.

⁴⁷ Shkresë e RBAL nr. ***, datë 12.3.2021.

⁴⁸ Shkresë e Credins Bank nr. ***, datë 11.3.2021.

⁴⁹ Shkresë e QKB-së nr. *** prot., datë 2.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 4.3.2021.

⁵⁰ Ortakët e tjerë, A.T me 50% të kuotave dhe M.M me 15% të kuotave.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021.

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. ***, datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

45.4 Në lidhje me burimin e krijimit të blerjes së aksioneve (50,000 lekë) rezultoi se bashkëjetuesi gjatë vitit 2015 ka pasur të ardhura nga aktiviteti me NIPT *** në shumën 517,000 lekë, të cilat rezultojnë të mjaftueshme⁵³ për të shlyer vlerën 50,000 lekë për blerjen fillestare të kuotave në shoqëri me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i trupit gjykues

45.5 Komisioni çmon se përputhet deklarimi me dokumentacionin e përcjellë dhe nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë shoqëri në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

46. Kuota në shoqërinë “**” sh.p.k., me NIPT ***. Shoqëria nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar dhe është me status “Pezulluar” në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëria do të çregjistrohet. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia (kapitali nuk është shlyer). Blerë nga R.B me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.9.2012, notere M.D (bashkëlidhur kontratat). Vlera: 100,000 lekë. Pjesa takuese: 35%.**

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

46.1 Nga hetimi rezultoi se personi i lidhur e ka deklaruar për herë të parë pjesëmarrjen në shoqëri në DIPP-në e vitit 2014.

46.2 QKB-ja⁵⁴ konfirmoi se shtetasi A.M rezultoi të ketë pasur 100% të aksioneve të regjistruara në datën 4.9.2012, të përfituara me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.9.2012, me palë shitëse shtetasin R.B, me çmim shitjeje 100,000 lekë. Gjithashtu, personi i lidhur rezultoi përfaqësues ligjor i shoqërisë “****” sh.p.k., e cila ka ndryshuar emrin në “****” në datën 20.10.2017. Pas blerjes së kuotave është regjistruar në QKB statusi “Pezulluar” në datën 13.9.2012. Ndërsa në datën 31.7.2019, me kontratë shitjeje (jo noteriale) është bërë transferimi i kuotave nga shtetasi A.M te shtetasja B.R me çmim shitjeje 500,000 lekë, i cili do të paguhet me dy këste deri në datën 31.3.2019.

46.3 DPT-ja⁵⁵ informoi se ky subjekt tregtar, me objekt veprimtarie “Agjenci publiciteti”, ka dorëzuar deklaratën e tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitin 2014, me vlerë 0 të ardhura dhe për vitet 2015 – 2016 nuk është bërë deklarim, pasi shoqëria ka qenë me statusin “Pezulluar”. Në tabelën më poshtë janë pasqyruar të dhënat financiare të përcjella nga DRT Tiranë⁵⁶ për këtë subjekt tregtar.

Tabela nr. 2

Viti	Qarkullimi	Fitimi	Humbja	Fitimi pas tatimit
2014	-	-	-	-

⁵³ Në mënyrë përpjesëtimore në muaj rezultoi vlera 43,083 lekë ose deri në datën e blerjes së aksioneve (datë 16.2.2015) rezulton vlera 64,625 lekë.

⁵⁴ Me shkresën e QKB-së nr. ***, datë 2.11.2023 dhe nr. ***, datë 4.3.2021, u informuam se NIPT-i i deklaruar nga personi i lidhur i përket shoqërisë “****”, e cila është regjistruar në datën 12.8.2012 me objekt veprimtarie realizimin e aktiviteteve në fushën e marketingut dhe ortakë z. E.M (49%) dhe z. E.M (51%), me status aktiv.

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2023.

2015	Pa dorëzuar	-	-	-
2016	Pa dorëzuar	-	-	-
2017	3,783,394	1,989,288	-	1,989,288
2018	8,194,830	295,949	-	281,152
2018 tatimfitimi	2,143,020	450,000	-	382,500
2019	157,917	-	173,043	-

46.4 Komisioni hetoi⁵⁷ nëse ekzistonte konflikti i interesit i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit dhe shoqëritë e sipërpërmendur, ose/dhe administratorët ortakët e saj, nga i cili nuk rezultuan indicie që subjekti të ketë ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këta shtetas dhe shoqëri.

46.5 Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës të blerjes së aksioneve (100,000 lekë), personi i lidhur deklaroi se kapitali nuk është shlyer deri në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting*. Ndërsa referuar QKB online rezultoi se në ekstraktin historik të shoqërisë, në datën 4.9.2012, është regjistruar veprimi i ndryshimeve të ortakut nga R.B në A.M. Bashkëlidhet edhe mandati bankar për shlyerjen e kapitalit⁵⁸ në bankë (Credins Bank) me vlerë 100 lekë.

Vlerësimi i trupit gjykues

46.6 Në përfundim, Komisioni çmon se nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë shoqëri në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

47. Aksione “**” sh.a.**, person juridik i regjistruar në datën 15.9.2014, me NIPT ***. *Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia para bashkëjetesës. Shoqëria është me status “Pezulluar” dhe nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar, mungojnë aktet nënligjore për kryerjen e veprimtarisë. Shoqëria do të çregjistrohet. Vlera: 10,000,000 lekë. Pjesa takuese: 33%.*

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

47.1 Për herë të parë, personi i lidhur ka deklaruar aksionet sa më sipër në deklaratën periodike vjetore 2014.

47.2 QKB-ja⁵⁹ konfirmoi se shtetasi A.M rezultoi administrator gjatë periudhës 10.9.2014 – 10.9.2017, anëtar i Këshillit Mbikëqyrës në periudhën 10.9.2014 – 10.9.2017 dhe ortak zotërues i 33%⁶⁰ të kuotave në shoqërinë “****” sh.a., e regjistruar në datën 15.9.2014, pajisur me NUIS (NIPT) ***. Prej datës 10.10.2016, statusi i shoqërisë rezultoi i pezulluar. Vlera e kapitalit të shoqërisë është 10,000,000 lekë. Bashkëlidhet kopje e mandatarkëtimit të vlerës prej 3,300,000 lekësh nga A.M në Credins Bank, me shënimin “Derdhje kapitali nga ortaku”, datë 29.7.2014, në favor të institutit ***. Gjithashtu, përcillet kopje e mandatarkëtimit me vlerë 24,304 euro nga A.S në Credins Bank për llogari të institutit *** në datën 16.7.2014. Nga QKB-ja përcillet kopje e bilancit financiar të viteve 2014 – 2015, ku rezultoi se gjendja e aktiveve monetare-bankë është

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. *** datë 4.12.2023; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

⁵⁸ Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 70 përcakton se: “Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 100 lekë”.

⁵⁹ Shkresë e QKB-së nr. *** prot., datë 2.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 4.3.2021.

⁶⁰ Së bashku me ortakët e tjerë, A.S me 34% të kuotave dhe TH.K me 33% të kuotave.

me vlerë 10,000,000 lekë për të dyja vitet dhe rezultoi se shoqëria nuk ka të ardhura të deklaruara për këto vite.

47.3 Credins Bank⁶¹ konfirmoi se në datën 16.7.2014 është depozituar shuma 3,400,129.6 lekë me përshkrimin “****, kalim kapitali fillestar për themelim A.M”. Në datën 29.7.2014 është depozituar shuma 3,300,000 lekë me përshkrimin “M.A - derdhje kapitali nga ortakut.” Ndërsa në datën 1.8.2014 është transferuar shuma 3,300,000 lekë me përshkrimin “TH.I.K trn no. ***, TH.K, derdhje e kuotave”.

47.4 Në lidhje me tërheqjen e shumës së derdhur për kapital:

47.4.1 Në datën 5.11.2014, shuma 3,300,000 lekë transferohet në llogarinë tjetër të shoqërisë (***) me përshkrimin “****, kalim nga ortakut/administratori A.M”. Nga kjo shumë, më pas vlera 1,000,000 lekë është transferuar me përshkrimin “**** sh.a. për kapital themeltar, A.M” dhe në datën 19.11.2014 është tërhequr *cash* vlera 1,000,000 lekë nga shtetasi A.M, i cili më pas e ka derdhur në llogari në datën 19.12.2014. Personi i lidhur ka kryer edhe veprime të tjera në këtë llogari, të cilat lidhen kryesisht me pagesat dhe shlyerjen e detyrimeve të shoqërisë ndaj institucioneve shtetërore, por edhe tërheqje *cash* gjatë periudhës 2.3.2015 – 4.9.2015, me vlerë totale 960,000 lekë.

47.4.2 Ndërsa në lidhje me pjesën tjetër të kapitalit të derdhur nga aksionerët e tjerë, shuma e mbajtur e bllokuar për kapital prej 6,700,129 lekësh është transferuar në datën 1.7.2015 me përshkrimin “****, kalim kapitali themeltar në llogari rrjedhëse, ****” në llogarinë rrjedhëse ***, nga të cilat i janë transferuar brenda ditës vlera 1,400,000 lekë shtetasit A.S me përshkrimin “Kalim në llogari të ortakut ****” dhe, në datën 3.7.2015, shuma 3,300,000 lekë i transferohet në llogari shtetasit TH.K me përshkrimin “Kalim në llogari të ortakut ****”.

47.4.3 Ndërsa vlera e mbetur prej 1,270,000 lekësh i transferohet në datën 21.7.2016 shtetasit G.M (vëllai i bashkëjetuesit) me përshkrimin “Dhënie huaje”.

47.5 DRT-ja Tiranë⁶² konfirmoi se shtetasi A.M rezultoi i regjistruar në organin tatimor me aktivitet ekonomik privat si administrator në subjektin tatimpagues “****” sh.a., regjistruar me NIPT ***, me objekt veprimtarie “Aktivitete të policisë”. Statusi i tatimpaguesit “Pasiv” nga data 27.9.2016 dhe për periudhën 2014 – 2016 nuk ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti (deklaratat e tatimfitimit me vlerë 0). Gjithashtu, nga shkresa e DPT-së⁶³ u konfirmua se personi i lidhur figuron si pagamarrës në **** (paga si administrator), me pagë bruto/neto 0 lekë për periudhën shtator 2012 – shtator 2016.

47.6 Komisioni hetoi⁶⁴ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit e sipërpërmendur dhe shoqëritë më lart ose/dhe administratorët ortakët e tyre, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këta shtetas dhe shoqëri.

47.7 Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës së kapitalit të shlyer nga personi i lidhur prej 3,300,000 lekësh, rezultoi se personi i lidhur ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të ardhurat e tij para bashkëjetesë, për të cilat Komisioni i kërkoi shpjegime⁶⁵ dhe subjekti sqaron:

⁶¹ Shkresë e Credins Bank nr. *** prot., datë 9.1.2024.

⁶² Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2023.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021.

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. ***, datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

⁶⁵ Pyetësor nr. 2, pyetja e parë.

*“...Nga shpjegimet e tij më ka informuar se burimi i krijimit janë të ardhurat e tij në vite, avokat dhe konsulent ligjor për individë dhe shoqëri të ndryshme, si nga të ardhurat e përbashkëta të familjes së tij bujqësore. Burimi i krijimit janë të ardhurat: a) 10,000 euro (konvertuar me lekë në shumën 1,400,000 lekë) nga zoti K.L (për këtë pagesë është dorëzuar për procesin e rivlerësimit deklarata noteriale lëshuar nga zoti K.L); b) 10,000 euro, me vlerë 1,400,000 lekë nga zoti R.Z (vërtetuar me transfertë bankare dhe vërtetuar nga shtetasi R.Z, bashkëlidhur në këtë përgjigje); c) 600,000 lekë nga të ardhurat nga avokatia për vitin 2011, ushtruar me NIPT ***. Bashkëlidhur kopje ekstrakti nga QKB-ja, ku rezultoi aktiv për vitin 2011. Për vitin ushtrimor 2011 janë paguar detyrimet ndaj administratës tatimore vendore.*

...Lidhur me të ardhurat e bashkëjetuesit A.M, sqaroj se ai dhe familja e tij janë përfitues të tokës bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën bujqësore”, dhe kanë pasur administrim të përbashkët të të ardhurave. ...Vëllai E.M ka emigruar në Greqi në vitin 1999, jeton dhe punon në Greqi me familjen e tij dhe nuk kontribuon prej këtij viti, kurse motra M.M (M) është martuar në vitin 1995 dhe po ashtu nuk kontribuon nga kjo periudhë. Kontributi në vite dhe të ardhurat janë të ndryshueshme, por në mënyrë konstante bashkëjetuesi A.M ka kontribuar dhe ka kryer administrim bashkë me babain U, i cili ka ndërruar jetë në janar 2013 dhe më pas i ka administruar me vëllain G.M. ...Bashkëlidhur përcillet vërtetim, i cili përmban të dhënat nga 2011, për shkak të faljeve para këtij viti për detyrimet për tokat bujqësore.”

47.8 Subjekti gjithashtu sqaron se: *“Saktësoj se me bashkëjetuesin kam nënshkruar kontratë për përcaktimin e regjimit pasuror martesor në datën 22.5.2017 (noter A. B. S) dhe, më pas, kemi lidhur martesë. Pra, çdo pasuri që ai ka krijuar para martese është e tij dhe lidhet vetëm me marrëdhëniet që ai ka me familjen e tij para martese dhe nuk kam të drejta ose detyrime. Këto pasuri, përfshirë kuotat/aksionet e shoqërive që janë deklaruar, janë pasuri të krijuara me të ardhura para martese dhe me burim të ardhurat e tij personale dhe familjes së tij. Ky saktësim vlen për të gjitha pasuritë e krijuara, që janë objekt i këtij pyetësi”.*

47.9 Komisioni konstaton se kjo kontratë e përcaktimit të regjimit pasuror martesor është nënshkruar në datën 22.5.2017, pak kohë para se të lidhej martesa ligjore e tyre, por gati tri vite pas krijimit të pasurisë dhe ndryshimeve të tjera në shoqëri. Në vijim, Komisioni do të analizojë secilën të ardhur të përdorur si burim krijimi mbështetur në shpjegimet e subjektit dhe personit të lidhur.

Në lidhje me burimet e deklaruara, Komisioni konstaton se:

47.10 Shuma 10,000 euro nga shtetasi K.L është provuar nga deklarata noteriale datë 15.1.2021, nr. *** rep., nr. *** kol., me deklarues shtetasit K.L dhe A.M, e përcjellë me përgjigjet e pyetësorit dhe në deklaratën *Vetting* (aneks ***), në të cilën deklarojnë se kanë nënshkruar kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2013, në bazë të së cilës shtetasi A.M ka marrë nga shtetasi K.L shumën 10,000 euro me para *cash* me dy këste: 5,000 euro në muajin dhjetor 2013 dhe 5,000 euro në muajin mars 2014.

47.10.1 Në DIPP-të e viteve 2013 – 2014 nuk ka deklarim për përfitim të të ardhurave nga kjo marrëdhënie juridike, ndërsa në DIPP-në e vitit 2015 deklararon tek të dhënat konfidenciale: *“Të ardhura të pritshme nga K.L. Padia e regjistruar në Gjykatën e Tiranës më 14.9.2015, pretendoj 30,000 euro si detyrim monetar ose shpërbllim në natyrë, duke transferuar pronësinë e pasurive të ekzekutuara nga shërbimi përmbartimor privat. K.L pretendon se nuk ka detyrime. Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2013, noter A.R.”*

47.10.2 Në deklaratën *Vetting*, personi i lidhur deklaroi: “*Parapagim nga K.L, nga Kontratë Shërbimi nr. *** rep *** kol., datë 30.4.2013, noter A.R. Për pjesën tjetër të detyrimit prej 30,000 euro po zhvillohet proces gjyqësor. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. ***, datë 26.4.2016, ka vendosur detyrimin që K.L të paguajë 30,000 euro. Vendimi i ankimuar nuk paraqitet me vulë pa marrë formë të prerë (dosja është në Gjykatën e Apelit Tiranë, në pritje për gjykim). Në përfundim të gjykimit do të vlerësohet pagesa e detyrimeve tatimore (debitori ka mundësi alternative të pagesës në natyrë, në varësi të pagesës llogaritet tatimi). Shuma 10,000 euro.*”

47.10.3 Në kontratën e shërbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2013, përcaktohet se personi i lidhur do të shlyhet për shërbimet juridike dhe avokatore që do të kryejë: (a) në rast të mbledhjes së huas *cash* nga debitori ose shitjes së pasurive të paluajtshme një vlerë prej 40,000 euro; (b) shpërblimin në pjesën takuese të vlerës së detyrimit me pasuri të paluajtshme; (c) pjesërisht *cash* dhe pjesërisht me pasuri të paluajtshme. Subjekti ka bashkëlidhur edhe vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. vendimi ***, datë 26.4.2016, në të cilin paditës është shtetasi A.M dhe i paditur është shtetasi K.L, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të përmbushë detyrimin që rrjedh nga kontrata e shërbimit, e nënshkruar para noterit A.R, me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 15.2.2013, duke paguar në favor të paditësit shumën 30,000 euro”. Për këtë vendim është bërë ankim nga pala e paditur.

47.10.4 Në përfundim të hetimit, Komisioni vlerësoi se në lidhje me shumën e parapaguar nga shtetasi K.L prej 10,000 euro në vitin 2013, nga komunikimi me DPT-në⁶⁶ dhe DRT-në⁶⁷ nuk rezultoi të jenë shlyer detyrimet tatimore për këtë shumë, në formën e deklarimit DIVA apo si person fizik – avokat me NIPT ***. Qarkullimi dhe fitimi neto i deklaruar për vitin 2013 është 0 lekë, ndërsa në vitin 2014 rezultoi fitim i deklaruar prej 840,386 lekësh nga aktiviteti i avokatisë.

47.10.5 Gjithashtu, Komisioni konstaton se kjo shumë e parapaguar është realizuar nga personi i lidhur për shkak të aktivitetit si avokat, çka do të duhej të deklarohet si e ardhur tek organet tatimore, tek NIPT-i aktiv i tij (***), për të cilin DRT-ja informoi se të ardhurat janë zero për vitin 2013. Pra, Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare të tij.

47.10.6 Komisioni nuk e ka përfshirë si të ardhur në analizën financiare vlerën 10,000 euro, pasi nuk përmbush kriteret e burimit të ligjshëm sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

47.11 Nga hetimi rezultoi se në datën 27.12.2010 është kryer transferimi i shumës 10,000 euro (me vlerë 1,400,000 lekë) në llogarinë e subjektit pranë Tirana Bank nga shtetasi R.Z, me përshkrimin “*Likuidim detyrimi*”, e cila është tërhequr në të njëjtën ditë nga personi i lidhur. Subjekti me pyetësin nr. 2 përcjell deklaratë të thjeshtë, datë 20.7.2023, nga shtetasi R.Z (ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë *** sh.p.k.), i cili deklaroi se pagesa është kryer si shpërblim për shërbimet e konsulencës së vazhdueshme, të kryera nga viti 2006 nga personi i lidhur me të. Më pas, shtetasi A.M ka qenë dhe i punësuar në shoqërinë “****” sh.p.k., ku shtetasi Z është ortak i vetëm dhe administrator. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se shuma e fitimit neto në vitin 2010 nga A.M-NIPT *** është 305,213 lekë. Gjithashtu, nuk rezultoi të jenë shlyer detyrime tatimore për të ardhurat personale⁶⁸, për vlerën 10,000 euro të transferuar nga shtetasi R.Z.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021.

⁶⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2023.

⁶⁸ Sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Gjithashtu, ISSH-ja nuk ka konfirmuar të ardhura nga paga për bashkëjetuesin pranë shoqërisë “****” sh.p.k., duke nisur nga viti 2006 deri në 2016-ën.

47.11.1 Në përfundim të hetimit, Komisioni vlerësoi se nuk u provua burimi i ligjshëm i vlerës 10,000 euro të transferuar në llogarinë e z. A.M pranë Tirana Bank me përshkrimin “Likuidim detyrimi”. Gjithashtu, subjekti nuk arriti të provojë shlyerjen e detyrimeve për këtë shumë të përfituar. Subjekti dhe/ose bashkëjetuesi nuk kanë deklaruar kursime *cash* në deklaratën e vitit 2012, kur bashkëjetuesit i lindi detyrimi për deklarim pasurie. Për këtë arsye, shuma si më lart e fituar në vitin 2010 nuk mund të jetë përdorur në vitin 2013 prej tij. Komisioni nuk e ka përfshirë në analizën financiare si burim krijimi për kapitalin e derdhur në shoqëri.

47.12 Subjekti deklaroi si burim të ligjshëm të ardhurat e fituara nga aktiviteti i avokatisë, i regjistruar me NIPT *** gjatë vitit 2011 në shumën 600,000 lekë. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se në këtë vit nuk deklarohen të ardhura dhe se aktiviteti rezultoi me humbje prej -28,500 lekësh. Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion deklarimin e saj dhe, si pasojë, shuma 600,000 lekë nuk mund të konsiderohet burim i ligjshëm për shumën e derdhur në kapitalin e shoqërisë.

47.13 Gjithashtu, në lidhje me deklarimin e subjektit për të ardhurat e përbashkëta të bashkëjetuesit nga familja e tij bujqësore, Komisioni konstaton se personi i lidhur dhe subjekti nuk kanë deklaruar në deklaratat periodike të ardhura nga ky aktivitet dhe nuk rezultuan prova të dokumentuara nga institucionet për gjenerimin e tyre nga familja bujqësore. Komisioni nuk përfshiu në analizën financiare të ardhura nga familja bujqësore e bashkëjetuesit.

47.14 Në përfundim të hetimit, Komisioni konstatoi se:

- Në lidhje me të ardhurat me vlerë 960,000 lekë, të deklaruara si parapagim në këtë shoqëri për personin e lidhur, nga hetimi u provua se këto të ardhura, të cilat kanë pasur si burim vlerën e depozituar për kapital themeltar të shoqërisë, nuk janë deklaruar në organet tatimore si pagë për shtetasin A.M. Pra, nuk janë shlyer as detyrimet tatimore për këto të ardhura. Komisioni nuk i përfshiu në analizë financiare këto të ardhura.

- Gjithashtu, Komisioni vlerësoi se personi i lidhur kishte detyrimin e deklarimit të pasurive, interesave etj. pranë ILDKPKI-së prej vitit 2012, por deklarimi i parë prej tij është bërë vetëm në vitin 2014. Në vijim, Komisioni nuk mund të përfshijë gjendje kursimesh *cash* të krijuara në periudhat e mëparshme (përpara deklarimit të parë) dhe pasi personi i lidhur nuk ka deklaruar gjendje *cash* në deklarimin e tij të parë.

- Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamundësinë financiare të rezultuar gjatë hetimit për vlerën -3,300,000 lekë, pasi subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të krijimit të saj.

47.15 Subjekti pas kalimit të barrës së provës dhe dërgimit të rezultateve të hetimit sqaron se:

47.15.1 Në lidhje me marrëdhënien e bashkëjetesës “*Fillimisht dua të sqaroj se bashkëjetuesit tim, z. M, i ka lindur detyrimi për deklarim pasurie në vitin 2014, bazuar në ndryshimet në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë”, me atë të ligjit nr. 45, datë 24.4.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë. Edhe në jurisprudencën e trupave të rivlerësimit është i mbajtur i njëjti qëndrim⁶⁹”.*

⁶⁹ Shihni vendimin e Komisionit nr. 410, datë 30.6.2021, si dhe vendimin nr. 11/2019 të Kolegjit.

47.15.2 Në lidhje me mospërfshirjen në analizën financiare të vlerës 10,000 euro si parapagim nga shtetasi K.L shpjegon se: *“Ashtu siç thekson edhe Komisioni në rezultatet e hetimit, pagesa e marrë është paradhënie dhe, si e tillë, nuk përfshihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, por në pasiv të bilancit dhe detyrimet tatimore për paradhënien paguhen në momentin kur pritet fatura përfundimtare. Pavarësisht këtij argumenti, në momentin e realizimit të këtyre të ardhurave bashkëshorti ka pasur të regjistruar në QKB dy subjekte tatimpaguese, për të cilat ka paguar detyrimet tatimore si biznes i vogël, pra në fashën nën 8,000,000 lekë, sipas vërtetimeve bashkëlidhur. Si rrjedhojë, këto të ardhura përmbushin kushtet e të ardhurave të ligjshme, dhe si të tilla duhet të përfshihen në analizën financiare. Por nuk janë paguar tatimet bazuar në faktin se palët kishin mosmarrëveshje për vlerën e rënë dakord me kontratë shërbimi dhe fatura është e vlefshme vetëm nëse pranohet nga pala tjetër. Në kushtet e lindjes së mosmarrëveshjes, tatimet do të paguhen në fund të marrjes së vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë, ku çështja është në pritje për gjykim. Theksoj se synimi i klientit të bashkëshortit për të marrë urdhrat e ekzekutimit, vënien në ekzekutim dhe mbledhjen e detyrimeve nga debitorët është përmbushur dhe duhet të kryhet pagesa sipas kontratës së shërbimit, gjë e cila nuk është kryer.”*

47.15.3 Në lidhje me shumën 10,000 euro të transferuar nga shtetasi R.Z në llogarinë e personit të lidhur pranë Tirana Bank, subjekti sqaron se bashkëlidhur me pyetësonin nr. 2 ka përcjellë deklaratë të thjeshtë, datë 20.7.2023, të shtetasit R.Z, në të cilën ai deklaroi se pagesa është kryer si shpërblim/dhuratë për shkak të marrëdhënies së bashkëpunimit të filluar nga viti 2006 me z. M. Gjithashtu, me shpjegimet përcjell deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.8.2024, para noteres M.S, ku bashkëlidhet kontratë qiraje datë 1.10.2007, me palë “C Bank” sh.a. dhe shtetasin R.Z, për dhënien me qira të pasurisë së paluajtshme me sip. 300 m² dhe vlerë 5,000 euro/muaj, të ndodhur në zonën e ***, me anë të së cilës provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të transferuara në llogarinë e bashkëjetuesit në Tirana Bank.

47.15.4 Në lidhje me të ardhurat e personit të lidhur nga familja bujqësore, subjekti pas përcjelljes së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore sqaron se: *“...paraqesim “Raport Vlerësimi” për përlllogaritjen e të ardhurave nga toka bujqësore, përgatitur nga eksperti i licencuar L.B. Në deklaratën e parë të pasurisë, bashkëshorti/bashkëjetuesi ka deklaruar “të ardhura nga familja bujqësore”, por pa specifikuar një vlerë konkrete, sepse këto të ardhura janë përfituar nga familja bujqësore, por në legjislacionin tatimor, sidomos përpara vitit 2014, nuk ka ekzistuar detyrimi i personave që jetonin në fshat të dokumentonin me faturë apo ndonjë mënyrë tjetër të ardhurat e realizuara nga toka bujqësore. Në vitin 2016, të ardhurat nga toka bujqësore janë të dokumentuara, për shkak se në këtë vit toka u dha me qira etj. Meqenëse bashkëshorti ka pasur të ardhura dhe produkte nga toka bujqësore, shpenzimet jetike të tij deri në fund të vitit 2014 duhet të reduktohen në masën 44%, ashtu siç është konsoliduar praktika e trupave të rivlerësimit në këtë drejtim”.*

47.15.5 Gjithashtu, subjekti sqaron edhe në lidhje me të ardhurat e tjera të bashkëjetuesit përpara bashkëjetesës, të cilat nuk ishin deklaruar gjatë procesit si burim për shumën e kapitalit të derdhur në këtë shoqëri si vijon.

47.15.6 Lidhur me të ardhura të tjera të padeklaruara në Vetting nga aktiviteti i avokatisë, regjistruar me NIPT ***, subjekti sqaron se: *“Nga informacioni i dërguar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, gjatë hetimit administrativ rezulton se ky subjekt tatimpagues është regjistruar në vitin 2008 dhe është çregjistruar në datën 31.5.2009 me xhiro të deklaruar prej 2-3 milionësh lekë në vit (pra, edhe në vitin 2009). Pra, bashkëshorti ka realizuar të ardhura edhe gjatë vitit 2009. Në deklaratën Vetting, ai ka deklaruar vetëm të ardhurat sipas të*

*dhënave të marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, por bazuar në informacionin e marrë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, rezulton se ky subjekt ka deklaruar xhiro në Bashki edhe për vitin 2009 dhe ka paguar tatimin për biznesin e vogël edhe për tremujorin e parë të këtij viti. Sipas legjislacionit tatimor në fuqi, për bizneset e vogla⁷⁰ me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi (sipas tabelës në varësi të aktivitetit dhe kategorisë). Ky detyrim paguhej në Bashki. Bazuar në legjislacionin e sipërcituar dhe referuar shkresës me nr. *** prot., datë 13.8.2024, të Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë, rezulton se në vitin 2009 bashkëshorti ka paguar 20,325 lekë detyrime tatimore në muajin prill të këtij viti, nga të cilat 15,000 lekë për taksën e biznesit të vogël (për tremujorin e parë). Pra, për vitin 2009, meqenëse të ardhurat e bashkëshortit nuk kanë qenë më të larta se 2,000,000 lekë, ai nuk ka përpiluar pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (sepse nuk ka qenë detyrim ligjor, sidomos kur të ardhurat kanë qenë më të vogla se 2,000,000 lekë (për tremujorin e parë të vitit 2009). Për këtë arsye, për tremujorin e parë të vitit 2009, fitimi neto i realizuar nga bashkëshorti si tatimpagues me NIPT *** duhet të përllogaritet në mënyrë alternative (ashtu siç është e konsoliduar praktika e trupave gjyqes të rivlerësimit), duke marrë për bazë të ardhurat dhe vlerën e vitit 2008, pra duke përllogaritur 1/4 e fitimit neto të vitit 2008. Bazuar në përllogaritjet e kryera, rezulton se të ardhurat e realizuara nga bashkëshorti (fitimi neto) gjatë vitit 2009 rezultojnë në shumën 1,053,730 lekë dhe, si rrjedhojë, të ardhurat nga personi fizik me NIPT *** përllogariten në shumën totale 5,268,651.25 lekë, shumë e cila mbulon tërësisht vlerën 4,612,305 lekë, që është paguar për këstin e parë të apartamentit dhe që është deklaruar si burim krijimi i kësaj pasurie në deklaratën Vetting”.*

Vlerësimi i trupit gjyqes

47.15.7 Komisioni çmon se shpjegimet e subjektit në lidhje me momentin e fillimit të deklarimit të bashkëjetuesit pranë ILDKPKI-së nuk janë bindëse dhe nuk janë të mbështetura në ligjin e kohës. Komisioni vlerëson se personit të lidhur në cilësinë e bashkëjetuesit i ka lindur detyrimi për të deklaruar nga momenti i ndryshimeve ligjore të vitit 2012.

47.15.8 Për shumën e marrë si paradhënie nga shtetasi K.L, trupi vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të mbështetura në prova. Të ardhurat e trajtuara si më lart në formën e paradhënies duhet të përfshihen në analizën financiare të rishikuar të Komisionit në vitin 2013.

47.15.9 Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të vlerës 10,000 euro, të transferuar në llogarinë e bashkëjetuesit nga shtetasi R.Z, trupi gjyqes vlerëson se subjekti arriti të provojë se ky shtetas ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë vlerën e mësipërme. Ndërsa në lidhje me qëllimin/arsyen e transferimit të kësaj vlere drejt llogarisë së shtetasit A.M, Komisioni konstaton se kjo vlerë të ardhurash deklarohet vetëm gjatë procesit të rivlerësimit të subjektit dhe se në deklaratat⁷¹ noteriale të shtetasit R.Z nuk përcaktohet se kjo shumë është dhuruar prej tij, por deklarohet se është dhënë si shpërblim⁷² për shërbimet e konsulencës të kryera nga personi i lidhur. Ndërsa transferata e shumës 10,000 euro e kryer nga shtetasi R.Z në datën 27.12.2010, në llogarinë e personit të lidhur në Tirana Bank, ka përshkrimin “likuidim detyrimi”. Komisioni çmoi se kjo shumë nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për derdhjen e

⁷⁰ Shihni vendimin nr. 4, datë 31.10.2022, të Kolegjit dhe vendimin nr. 689, më 24.7.2023, të Komisionit.

⁷¹ Deklarata nr.*** rep., nr. *** kol., datë 19.8.2024 dhe deklarata noteriale e datës 20.7.2023.

⁷² Specifikohet në deklaratën noteriale datë 20.7.2023: “...Në datën 27.12.2010 është bërë pagesa me vlerë 10,000 euro në llogarinë në Tirana Bank ...Kjo pagesë është kryer si shpërblim për shkak të shërbimeve të konsulencës së vazhdueshme të kryer nga ju. Për shkak të konsulencave dhe këshillimit ligjor që kanë filluar nga viti 2006 e në vijim, kjo ka qenë një pagesë shpërblim...”.

kapitalit në shoqëri nga bashkëjetuesi, pasi vlerësoi se qëllimi i transferimit të shumës 10,000 euro është shpërblim për punën e kryer nga bashkëjetuesi, për të cilën nuk u arrit të provohej shlyerja e detyrimeve tatimore.

47.15.10 Gjithashtu, Komisioni vlerësoi se nuk mund të përfshihen në analizën financiare të ardhura me burim familjen bujqësore, pasi subjekti dhe bashkëjetuesi nuk kanë deklaruar shuma të ardhurash të përfituara prej aktivitetit bujqësor gjatë deklarimeve periodike dhe as në deklaratën *Vetting*. Gjithashtu u provua gjatë hetimit se personi i lidhur banonte dhe punonte në mënyrë të vazhdueshme në qytetin e Tiranës. Për këtë arsye, nuk mund të aplikohen edhe shpenzime jetike të reduktuara.

47.15.11 Ndërsa për të ardhurat e vitit 2009 nga aktiviteti me NIPT ***, trupi gjykues vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe se provohet se personi i lidhur ka shlyer detyrimet tatimore për tremujorin e parë të vitit 2009 për xhiron 2-3 milionë lekë. Komisioni vlerëson se në analizën e përditësuar të tij duhet të përfshihen si të ardhura vetëm sa ka rezultuar gjatë periudhës së parë të vitit, për të cilën u provua shlyerja e detyrimeve tatimore. Pra, duhet përfshirë vlera 400,000 lekë, e llogaritur nga qarkullimi kufi prej 2,000,000 lekësh, me marzh 80% të aktivitetit të avokatisë sipas praktikës së Kolegjit, vetëm për tremujorin e parë të vitit 2009 (pra, $2,000,000 \cdot 0.8/4 = 400,000$ lekë), por duke qenë se personi i lidhur nuk ka deklaruar vlerë kursimesh *cash* në fund të vitit 2012, kjo vlerë nuk mund të mbartet në vitin 2014 e të përdoret si burim për derdhjen e kapitalit në shoqëri.

47.15.12 Në përfundim për sa trajtuar më lart, Komisioni vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me pamundësi financiare në krijimin e shumës për blerjen e kuotave në shoqëri, në vlerën totale -3,300,000 lekë, pasi personi i lidhur nuk ka deklaruar gjendje kursimesh *cash* në fund të vitit 2013, të cilat mund të ishin krijuar nga të ardhurat e tij para fillimit të bashkëjetesës.

48. Aksione në shoqërinë “**” sh.a., me NIPT ***.** Burimi i krijimit: Nuk është paguar pjesa e kapitalit. Shoqëria nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar për mungesë të bazës ligjore për licencim (nuk është licencuar). Shoqëria do të çregjistrohet. Vlera: 50,000,000 lekë. Pjesa takuese: 40%⁷³.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

48.1 Personi i lidhur deklaron në DIPP-në e vitit 2015 pjesëmarrjen në shoqëri.

48.2 Nga hetimi⁷⁴ u konfirmua se shtetasi A.M rezultoi të jetë ortak zotërues i 40% të kuotave⁷⁵ dhe deri në datën 3.10.2016 ka qenë edhe administrator në shoqërinë “****” sh.a., me NIPT ***, e regjistruar në datën 6.1.2015, me objekt veprimtarie “Aktivitete të lojërave të fatit”, me kapital 50,000,000 lekë, nga të cilat vlera e kapitalit të shlyer është 14,243,160 lekë.

48.3 Credins Bank⁷⁶ informoi se shoqëria “****” sh.a. ka pasur numër llogarie ***, në të cilin në datën 23.12.2014 i është transferuar shuma 125,000 USD nga llogaria e ***, me përshkrimin “**** sh.a. – kontributi në kapital i aksionerëve **** sh.a.”. Ndërsa në datën 5.2.2015 është transferuar shuma në llogari 124,000 USD drejt *** me përshkrimin “*return of capital* - kthim i kapitalit”.

⁷³ Bashkëlidhet me deklaratën *Vetting* në Aneksin nr. *** dokumentacioni justifikues.

⁷⁴ Shkresë e QKB-së nr. *** prot., datë 2.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 4.3.2021.

⁷⁵ Shtetasi G.B është aksioner me 20% të kuotave, “****” 2% të kuotave, “****” 23% të kuotave dhe “****”, “****” Sh sh.p.k. me 15% të kuotave.

⁷⁶ Shkresë e Credins Bank nr. ***, datë 9.1.2024.

48.4 Nga komunikimi me institucionet tatimore rezultoi se për këtë subjekt nuk janë deklaruar të ardhura gjatë periudhës 2015 – 2019.

48.5 Komisioni hetoi⁷⁷ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit dhe shoqëritë e sipërpërmendura ose/dhe administratorët, ortakët e tyre, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me ta.

48.6 Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës të kapitalit, Komisioni me pyetësonin nr. 2 kërkoi shpjegime dhe dokumentacion provues në lidhje me burimin e krijimit të shumës 20.000.000 lekë në vitin 2015, duke iu referuar deklaramit në DIPP-në e vitit 2015, për të cilin subjekti sqaron: *“Lidhur me shoqërinë “***” sh.a., me NIPT ***, nga shpjegimet e bashkëshortit dhe siç rezulton nga ekstrakti i QKB-së, kapitali i shoqërisë është 50.000.000 lekë, minimumi që kërkon ligji nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i shfuqizuar në vitin 2015. Nga këto ai zotëron 40% të kuotave në shoqëri. Por, nuk ka paguar pjesën e tij të kapitalit dhe nuk ka paguar asnjë shumë për themelimin e shoqërisë. Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, lejon që shoqëritë aksionere të regjistrohen nëse paguhet një e katërta e kapitalit, parashikuar kjo në nenin 113 të ligjit. Për themelimin/regjistrimin e shoqërisë është paguar një e katërta e kapitalit nga një prej ortakëve të tjerë dhe kjo ka lejuar themelimin e në vijim regjistrimin e shoqërisë. Rezulton nga ekstrakti lëshuar nga QKB-ja se vlera e shlyer është 14,243,160 lekë, që korrespondon me një të katërtën e kapitalit të shoqërisë. Vërtetohet me mandat bankar nga Credins Bank sh.a. se shoqëria “***” ka paguar në bankë shumën që kërkohet nga ligji për të themeluar dhe regjistruar shoqërinë. Bashkëjetuesi A.M nuk ka paguar pjesën e kapitalit dhe, për rrjedhojë, nuk ka burim krijimi. Sqarohet se kjo shoqëri nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar, pasi nuk është licencuar, por nuk është çregjistruar për shkak se kërkon 100 për qind të aksionerëve pjesëmarrës për votimin.”*

48.7 Komisioni konstaton se analiza financiare e vitit 2014 rezultoi me vlerë negative, pra personi i lidhur dhe subjekti nuk kanë pasur mundësi të kursejnë vlerën e pjesës së saj takuese për derdhje kapitali në shoqëri, në janar të vitit 2015.

48.8 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamundësinë financiare prej -20,000,000 lekësh në krijimin e vlerës së pjesës takuese të saj në kapitalin themeltar të shoqërisë⁷⁸.

48.9 Subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore dhe me shpjegimet e përcjella së bashku me aktin e ekspertimit sqaron: *“Lidhur me shoqërinë “T” sh.a. vërtetohet nga ekstrakti i lëshuar nga QKB-ja dhe nga shkresa e QKB-së se aksioneri “***” *** ka paguar një të katërtën e kapitalit, që lejon regjistrimin e shoqërisë. Ligji nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, neni 113 “Shlyerja dhe kalimi i kontributeve përpara regjistrimit” përcakton se: “1. Aksionet e nënshkruara me kontribut në para duhet të shlyhen përpara regjistrimit të shoqërisë, të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale. Shumat që mbeten, shlyhen në një ose më shumë këste, sipas vendimit të organeve të administrimit të shoqërisë. Vlerat më të larta, sipas pikës 2 të nenit 110 të këtij ligji, duhet të shlyhen plotësisht. 2. Aksionet e nënshkruara me kontribut në natyrë duhet të kalohen tërësisht përpara regjistrimit. 3. Themeluesit, të cilët nuk shlyejnë apo kalojnë kontributet e tyre brenda afateve të përcaktuara më sipër, përgjigjen ndaj shoqërisë në përputhje me përcaktimet e neneve 10, pikat 2 e 3 dhe 124 të këtij ligji.”. Pra, një nga aksionerët ka paguar*

⁷⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. ***, datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr.*** prot., datë 12.6.2024.

⁷⁸ Kapitali 50,000,000 lekë, ndërsa pjesëmarrja e tij në 40% të kuotave.

vlerën e lejuar nga ligji, që mundëson regjistrimin e shoqërisë. Po ashtu, ligji nr. 9901/2008 kërkon domosdoshmërisht pagesën në bankë të kapitalit dhe nuk ka asnjë mundësi ligjore dhe teorike të pagesës të kapitalit jashtë sistemit bankar. Nga komunikimet shkresore me institucionet bankare dhe institucionet jo banka konfirmohet në mënyrë shteruese se nuk është kryer asnjë pagesë tjetër për kapitalin e, për rrjedhojë, të nevojitet provë për burimin e krijimit. Po ashtu, është detyrim që nëse do të kishte pagesë pas regjistrimit, kjo do pasqyrohej dhe në bilancin e shoqërisë, i cili në fakt ka të dhëna me 0 për zërat e bilancit, ku do duhej të pasqyrohej pagesa e kapitalit. Në mungesë të kryerjes së aktivitetit, nuk ka arsye të pagesave të kapitalit nga aksionerët e shoqërisë. Lidhur me vlerën e kapitalit të shoqërisë prej 50,000,000 lekësh, ai është përcaktuar, pasi ligji nr. 10033/2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar dhe i shfuqizuar më pas, parashikonte një minimum kapitali prej 50,000,000 lekësh, në mënyrë që një shoqëri të garantojë ushtrimin e aktivitetit. Pra, në regjistrim shoqëria ka zbatuar kriteret minimale të regjistrimit nga ligji tregtar dhe ka parashikuar kapitalin minimal në aktet e themelimit parashikuar nga ligji “Për lojërat e fatit” dhe nuk ka pasur arsye të paguajë më shumë se detyrimi ligjor, parashikuar në nenin 113 të ligjit nr. 9901/2008”.

Vlerësimi i trupit gjykues

48.10 Trupi gjykues çmon se në analizë të provave të administruara, si dhe shpjegimeve të subjektit, ato janë bindëse, të mbështetura në prova dhe në kuadrin ligjor të krijimit të shoqërive tregtare. Komisioni çmon se sipas kuadrin ligjor një shoqëri përpara regjistrimit të saj duhet të shlyejë të paktën në një të katërtën e vlerës së tyre nominale. Gjithashtu një kërkesë e detyrueshme ligjore është kryerja e pagesës në bankë të kapitalit. Nga hetimi nuk rezultuan pagesa të tjera për kapitalin nga të gjithë institucionet bankare dhe jo bankare. Për sa më sipër, në analizën financiare të Komisionit nuk do të përfshihet shlyerja e pjesës së kapitalit nga personi i lidhur në këtë shoqëri, pasi kjo nuk rezultoi të jetë kryer prej tij.

49. Aksione në shoqërinë “**” sh.a., me NIPT ***.** Burimi i krijimit: Nuk është paguar pjesa e kapitalit. Shoqëria nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar për mungesë të bazës ligjore për licencim (nuk është licencuar). Shoqëria do të çregjistrohet. Vlera: 50.000.000 lekë. Pjesa takuese: 40%⁷⁹.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

49.1 Personi i lidhur deklaron në DIPP-në e vitit 2015 pjesëmarrjen në shoqëri.

49.2 Nga hetimi⁸⁰ rezultoi se shtetasi A.M është ortak zotërues i 40% të kuotave⁸¹ dhe deri në datën 9.5.2016 ka qenë edhe administrator në shoqërinë “****” sh.a., me NIPT ***, regjistruar në datën 13.5.2015, me objekt veprimtarie “Aktivitete të lojërave të fatit”, me kapital 50,000,000 lekë, nga të cilat vlera e kapitalit të shlyer është 14,160,200 lekë. Përcillet mandatpagesë pranë Raiffeisen Bank i datës 7.4.2015, nëpërmjet të cilit transferohet shuma 101,000 euro në llogarinë e shoqërisë “****” sh.a. nga llogaria e shtetasit të huaj R. TH. L. B me përshkrimin “Kalim për

⁷⁹ Subjekti përcjell dokumentacionin justifikues bashkëlidhur deklaratës Vetting, aneksi nr. ***.

⁸⁰ Shkresë e QKB-së nr. *** prot., datë 2.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 4.3.2021.

⁸¹ Shtetasi G.B është aksioner me 20% të kuotave, “****” 2% të kuotave, “****” 23% të kuotave dhe “****”, “****” Sh sh.p.k. me 15% të kuotave.

kapital” dhe pasqyrat financiare të shoqërisë, nga të cilat konfirmohet deklarimi i personit të lidhur për moskryerje të aktivitetit.

49.3 Raiffeisen Bank⁸² informoi se shoqëria “****” sh.a. ka pasur numër llogarie ***, i cili aktualisht është i mbyllur. Nga *statement*-i i llogarisë konfirmohen veprimet e mësipërme të kryera në datën 7.4.2015 dhe u informuam se kjo shumë është ritransferuar në datën 13.5.2015, në llogarinë e administratorit R. TH. L. B.

49.4 Rezultoi se kjo shoqëri ka pasur llogari bankare në BKT⁸³, të cilat janë hapur më 13.8.2015. Llogaria në monedhën lekë (***) është përdorur për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe taksave të shoqërisë deri në vitin 2020. Në llogarinë në USD rezultoi se në datën 2.11.2015 është transferuar shuma 2,069,930 USD nga “****”, me përshkrimin “**** - hua e aksionerëve”. Pas shlyerjes së disa pagesave me transferta bankare, vlera prej 2,001,777 USD i është kthyer shoqërisë “****” me transfertë bankare datë 19.11.2015.

49.5 Nga komunikimi me institucionet tatimore⁸⁴ rezultoi se gjatë periudhës 2015 – 2019 nuk janë deklaruar të ardhura dhe fitim nga shoqëria.

49.6 Komisioni hetoi⁸⁵ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit dhe shoqëritë e sipërpërmendura ose/dhe administratorët ortakët e tyre, nga ku rezultoi se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me ta.

49.7 Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës të kapitalit, me pyetësonin nr. 2 Komisioni kërkoi shpjegime dhe përcjelljen e dokumentacionit provues për burimin e krijimit të shumës 20,000,000 lekë në vitin 2015, duke iu referuar deklaramit në DIPP-në e vitit 2015, për të cilin subjekti sqaron: *“Nga shpjegimet e tij dhe siç rezulton nga ekstrakti i QKB-së, kapitali i shoqërisë është 50,000,000 lekë, minimumi që kërkonte legjislacioni i kohës dhe konkretisht ligji nr. 10033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar. Nga këto, bashkëjetuesi zotëron 40% të kuotave në shoqëri, por nuk ka paguar pjesën e tij të kapitalit dhe nuk ka paguar asnjë shumë për themelimin e shoqërisë. Ligji nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, lejon që shoqëritë aksionere të regjistrohen nëse paguhet një e katërta e kapitalit, parashikuar kjo në nenin 113 të ligjit. Për themelimin e shoqërisë është paguar pjesa e kapitalit dhe kjo ka lejuar themelimin e shoqërisë. Rezulton nga ekstrakti lëshuar nga QKB-ja se vlera e shlyer është 14,160,200 lekë, që korrespondon me një të katërtën e kapitalit të shoqërisë. Vërtetohet me mandat bankar nga Raiffeisen Bank sh.a. se shtetasi holandez R. Th. B. ka transferuar në bankë, në datën 7.4.2015, shumën që është përdorur për të themeluar shoqërinë. Më tej, kjo shumë është transferuar po nga Raiffeisen Bank sh.a. Çdo veprim është bërë me transferta bankare dhe çdo transfertë verifikohet për dërguesin dhe marrësin nga institucione ndërkombëtare bankare. R. Th. B. ka qenë në çastin e themelimit dhe pagesës së kapitalit një nga administratorët e shoqërisë “****” sh.a. Pra, bashkëjetuesi A.M nuk ka paguar pjesën e kapitalit dhe, për rrjedhojë, nuk ka burim krijimi”.* Nga komunikimi me Raiffeisen Bank sh.a., i trajtuar më lart, rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me përgjigjen e përcjellë prej tij.

⁸² Shkresë e RBAL nr. *** prot., datë 5.12.2023.

⁸³ Shkresë e BKT-së nr. *** prot., datë 26.12.2023.

⁸⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 21.12.2023.

⁸⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

49.8 Gjithashtu, Komisioni kërkoi shpjegime⁸⁶ nga subjekti në lidhje me kërkesën e bashkëjetuesit⁸⁷ në datën 16.11.2015, për të transferuar shumën 2,070,000 USD, si kthim huaje në favor të dërguesit fillestar, pra tek shoqëria “***”. Subjekti sqaron: “Lidhur me transfertën e shoqërisë “***”, bashkëjetuesi sqaron se kjo transfertë është bërë nga shoqëria “***”, e cila është një nga aksionerët e shoqërisë “***” sh.a., me NIPT ***, siç rezulton nga ekstrakti i QKB-së. Pra, nga një shoqëri tregtare aksionere tek shoqëria ku ajo është aksionere, me transfertë nëpërmjet bankave ndërkombëtare, pra pas verifikimit të vlerës nga institucionet ndërkombëtare të përfshira në kryerjen e transfertës. Legjislacioni “Për lojërat e fatit” parashikonte pagesën e një garancie bankare për pajisjen me licencë ushtrimi aktiviteti të çdo shoqërie, për aktivitet lojërash fati online, në vlerën e barabartë me këtë transfertë. Kjo transfertë ka ardhur në rrugë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare sh.a., me iniciativë të ortakut të shoqërisë, konkretisht “***”, dhe jo me kërkesë të shoqërisë “***” sh.a., me qëllim depozitimin si garanci bankare për licencim, për të përmbushur një kërkesë ligjore para licencimit. Por, shoqëria “***” sh.a. nuk u pajis asnjëherë me licencë ushtrimi aktiviteti dhe e njëjta pagesë, në të njëjtën shumë, u dërgua pas në të njëjtin numër llogarie nga ku ishte bërë transferta. Pra, është një pagesë e kryer me bankë dhe e kthyer pas me bankë, veprim tregtar për shkak të kërkesave ligjore për pajisje me licencë ushtrimi aktiviteti. Përfshirja e bashkëjetuesit është bërë vetëm se për të kthyer pagesën tek dërguesi, duhej të nënshkruhej nga të dy administratorët e shoqërisë “***” sh.a. dhe nuk ka qenë i përfshirë në transfertën e dërgimit në Shqipëri të pagesës. Statuti i shoqërisë parashikonte që çdo veprim bëhej nga të dy administratorët dhe, për këtë arsye, është nënshkruar transferta për t’u kthyer vlera përsëri tek dërguesi (më pas është larguar si administrator). Pra, nuk është bërë me iniciativën e tij, por në cilësinë e bashkadministratorit të shoqërisë. Administratori tjetër i shoqërisë, shtetasi holandez R. B nuk mund ta bënte këtë transfertë i vetëm (aktualisht është administrator i vetëm, pasi bashkëshorti i subjektit është larguar si administrator në vitin 2016). Nga ekstrakti i shoqërisë, në faqen e parë, kolona 15, përcaktohet se: “Administratorët duhet të veprojnë me firmë të përbashkët”. Në çastin e kryerjes së transfertës kanë qenë dy administratorë, bashkëjetuesi dhe R. B. Bashkëlidhur ekstrakti i QKB-së”.

49.9 Komisioni konstaton se analiza financiare e vitit 2014 rezultoi me vlerë negative. Pra, personi i lidhur dhe subjekti nuk kanë pasur mundësi të kursejnë vlerën e pjesës së tij takuese për derdhje kapitali në shoqëri, në janar të vitit 2015.

49.10 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamundësinë financiare prej -20,000,000 lekësh në krijimin e vlerës së pjesës takuese të saj në kapitalin themeltar të shoqërisë⁸⁸.

49.11 Subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore dhe me shpjegimet e përcjella së bashku me aktin e ekspertimit sqaron: “...Lidhur me shoqërinë “***” sh.a., argumentimi më sipër (referuar këtu “***” sh.a.) është i njëjtë lidhur me interpretimin e ligjit nr. 9901/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar dhe ligjit nr. 10033/2008 “Për lojërat e fatit”, i ndryshuar - në fuqi në kohën e regjistrimit dhe i shfuqizuar më pas. Në këtë rast, kapitali minimal i kërkuar nga ligji nr. 9901/2008, neni 113 i tij, është paguar nga aksioneri R. Th. B nëpërmjet sistemit bankar, konfirmuar kjo nga banka dhe shkresërisht nga Qendra Kombëtare e Biznesit.”

Vlerësimi i trupit gjykues

⁸⁶ Pyetësori nr. 2, pyetja nr. 5.

⁸⁷ Shihni aneksin *** në dosjen e ILDKPKI-së.

⁸⁸ Kapitali 50,000,000 lekë, ndërsa pjesëmarrja e tij në masën 40% të kuotave.

49.12 Trupi gjykues çmon se në analizë të provave të administruara, si dhe shpjegimeve të subjektit rezultoi se ato janë bindëse, të mbështetura në prova dhe në kuadrin ligjor të krijimit të shoqërive tregtare. Komisioni çmon se sipas kuadrin ligjor një shoqëri përpara regjistrimit të saj duhet të shlyejë të paktën një të katërtën e vlerës së tyre nominale. Gjithashtu, një kërkesë e detyrueshme ligjore është kryerja e pagesës në bankë të kapitalit. Nga hetimi nuk rezultuan pagesa të tjera për kapitalin nga të gjitha institucionet bankare dhe jobankare. Për sa më sipër, në analizën financiare të Komisionit nuk do të përfshihet shlyerja e pjesës së kapitalit nga personi i lidhur në këtë shoqëri, pasi kjo nuk rezultoi të jetë kryer prej tij.

50. Të ardhura të pritshme nga kontrata e shitjes së aksioneve shtetasit J.J, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2016, notere M.D. Vlera: 8,000,000 lekë. Pjesa takuese: 100%⁸⁹.

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

50.1 Në DIPP-në e vitit 2014, bashkëjetuesi deklaroi: *“Aksione në “****” sh.a., NIPT ***, me adresë B., Elbasan. Zotëroj 30,000 aksione, blerë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2013 para noterës M.D. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia. Vlera 30,000 aksione, me vlerë 49,980,000 lekë. Pjesa takuese: 30%.”*

50.2 Komisioni konstaton se personi i lidhur ka pasaktësi në deklarim, pasi nuk deklaroi në DIPP-në e vitit 2016 shitjen e aksioneve të shoqërisë “****” sh.a., por në deklaratën *Vetting* bën deklarin e të ardhurave të pritshme nga shtetasi J.J për vlerën e shitjes së aksioneve pranë kësaj shoqërie.

50.3 QKB-ja⁹⁰ konfirmoi se shtetasi A.M figuron të ketë qenë aksioner me 30.32% dhe larguar në datën 16.5.2016 në shoqërinë “****” sh.a., me NIPT ***, e regjistruar në datën 7.7.1996 dhe themeluar në datën 2.8.1995. QKB-ja online informoi se shtetasi A.M ka blerë 29,960 aksione të shoqërisë me kontratë të shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2013, nga shtetasi K.K, për transferimin e 30% të aksioneve në favor të tij. Në kontratë është përcaktuar se vlera e çmimit të blerjes së tyre është 8,303,809 lekë, ndërsa numri i aksioneve është rritur në 31,980, sipas vendimit të asamblesë së përgjithshme të aksionerëve datë 23.9.2013 për zmadhimin e kapitalit nga fitimi i realizuar nga viti 2012; me vendim të asamblesë së ortakëve datë 24.11.2014 është rizmadhuar kapitali i shoqërisë dhe numri i aksioneve të z. A.M shkon në 49,980; me vendimin nr. ***, datë 12.11.2015, rritet numri i aksioneve në 66,900 prej zmadhimit të kapitalit prej fitimit të vitit paraardhës.

50.4 Në lidhje me blerjen e kuotave të shoqërisë, personi i lidhur përcjell pranë ILDKPKI-së⁹¹ kopje të mandatpagesës pranë Credins Bank, ku në datën 12.9.2013 shtetasi A.M depoziton në arkë, në llogari të shtetasit K.K, vlerën 8,303,809 lekë, me përshkrimin A.M sipas kontratës nr. *** rep., nr.*** kol., datë 11.9.2013.

50.5 Nga kontrata e shitjes së aksioneve nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2016, rezultoi se pala shitëse A.M i shet palës blerëse J.J 66,900 aksione, që shitësi zotëron në shoqërinë “****” sh.a. me veprimtari *“Riparimet dhe remontet e mesme dhe kapitale të makinave elektrike”*, në vlerën 8,310,000 lekë, çmim i cili do të paguhet në mënyrë bankare nga blerësi. Me shitjen e aksioneve

⁸⁹ Dokumentacioni justifikues bashkëlidhur deklaratës *Vetting* në aneksin nr. ***.

⁹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2021.

⁹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 5.3.2021.

blerësit i kalon titulli i pronësisë të 66,900 aksioneve, të cilat përfaqësojnë 30% të aksioneve të kapitalit të shoqërisë “****” sh.a.

50.6 DPT-ja⁹² përcjell kopje të deklaratave të tatimit mbi fitimin për vitet 2015 – 2016, nga të cilat informoi se statusi i shoqërisë është aktiv prej datës 22.2.2001. Sipas deklaratës së fitimit 2015, të ardhurat janë 140,915,657 lekë dhe fitimi neto para tatimit është 100,774,056 lekë, ndërsa në vitin 2016 të ardhurat janë 170,709,711 lekë dhe fitimi neto para tatimit është 107,589,626 lekë. Gjatë hetimit nuk rezultoi që shtetasi A.M të ketë përfituar të ardhura nga kjo shoqëri as në formën e pagës dhe as si dividend, pasi gjatë këtyre viteve shoqëria nuk ka shpërndarë dividend.

50.7 Komisioni hetoi⁹³ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit dhe shoqëritë e sipërpërmendura, ose/dhe administratorët/ortakët e tyre dhe rezultoi se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këta shtetas dhe shoqëri.

50.8 Gjithashtu, prej komunikimit me Agjencinë e Prokurimeve Publike (APP)⁹⁴ rezultoi se shoqëria “****” sh.a. është regjistruar në datën 27.2.2008 në regjistrin SPE. Nga viti 2009 rezultoi se kjo shoqëri ka marrë pjesë në prokurimet e fondeve publike dhe është shpallur fitues 29 herë gjatë periudhës 2011 – 2022, prej të cilave 11 herë në periudhën 2013 – 2016, kur ka qenë aksioner personi i lidhur me subjektin, të detajuara në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3

Viti	Autoriteti kontraktor	Fondi limit
2013	Ujësjiellës-Kanalizime L sh.a.	1,080,000 lekë dhe 2,244,000 lekë
2014	Reparti Ushtarak nr. ***, Komanda e Forcave Detare ***	370,600 lekë
2015	A sh.a.	4,500,000 lekë
	*** sh.a.	134,000,000 lekë
	UK Sh	563,333 lekë
	Ujësjiellës P	520,000 lekë
2016	*** sh.a.	100,000,000 lekë
	UK Sh sh.a.	435,000 lekë
	UK P sh.a.	1,300,000 lekë
	*** sh.a.	134,000,000 lekë

50.9 Në procesverbalin e ILDKPKI-së, mbajtur në datën 31.3.2016, subjekti dhe bashkëjetuesi kanë dhënë shpjegime në lidhje me konfliktin e interesit në këtë shoqëri si më poshtë: “*Kam blerë aksionet sipas kontratës noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.9.2013, para noterit publik M.D, me çmimin 8,000,000 lekë. Kjo shoqëri në momentin e blerjes ka pasur kontratë me shoqërinë *** sh.a., ku aksionere ka qenë kompania e huaj ***. Jam informuar nga administratori i*

⁹² Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021.

⁹³ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023; shkresë nr. *** prot., datë 4.12.2023; shkresë e Prokurorisë së Rrethit Tiranë nr. *** prot., datë 18.6.2024; shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

⁹⁴ Shkresë e APP-së nr. *** prot., datë 3.1.2024.

shoqërisë se aktualisht aktiviteti kryhet vetëm me shoqëri aksionere, që funksionojnë sipas ligjit tregtar nr. 9901/2008. Sqaroj se administrimi i shoqërisë kryhet nga administratori i saj dhe unë jam aksioner me 30% të shoqërisë dhe ka 18 aksionerë të tjerë. Sqaroj se nuk kam pasur informacion të përditësuar për aktivitetin e saj dhe përfitimet e fondeve. Shoqëria është e vetmja shoqëri në Shqipëri, që ka objekt aktiviteti remont transformatorësh dhe, për këtë arsye, ka aktivitet në këtë fushë. Selia e saj është në Elbasan, B dhe nuk ka aktivitet në K ose në territorin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor K. Nga momenti i blerjes së aksioneve shoqëria nuk ka ndarë dividend dhe unë rrjedhimisht nuk kam përfitur nga fondet e shoqërisë. Sqaroj se i kam shitur aksionet dhe kam dalë nga shoqëria. Burimi i krijimit është nga të ardhurat e mia nga avokatia, nga shpërblime dhe nga të ardhurat e familjes sime në Lushnjë, me të cilën unë ushtroj aktivitet ekonomik të pandërprerë, pavarësisht se jetoj në Tiranë. Aksionet në këtë shoqëri i kam shitur më 23.3.2016, sipas kontratës noteriale nënshkruar para noterit publik M.D dhe përfundimisht kam dalë nga shoqëria”.

50.10 Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës së blerjes së aksioneve në shoqëri, subjektit i janë kërkuar shpjegime me pyetësorin nr. 2 për burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 8,303,809 lekë, e përdorur për blerjen e aksioneve në shoqërinë “****” sh.a., në vitin 2013. “Lidhur me deklarinimin mbi shoqërinë “****”, identifikuar me NUIS ***, dhe marrëdhëniet me zotin J.J, nga shpjegimet e bashkëjetuesit A.M sqaroj si vijon: akti juridik me të cilin janë blerë aksionet, është lidhur në datën 11.9.2013, me nr. *** rep., nr. *** kol., notere publike M.D, mes shitësit K.K dhe blerësit A.M, me çmimin 8,303,809 lekë... Bashkëlidhur kontrata e depozituar në QKB dhe ekstrakt i shoqërisë “****” sh.a. Aksionet janë transferuar me shitje tek blerësi, zoti J.J, me kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.3.2016, lidhur para noteres M.D. Vlera e shitjes është 8,310,000 lekë. Kjo shumë nuk është arkëtuar dhe rrjedhimisht është deklaruar si e ardhur e pritshme. Bashkëjetuesi A.M nuk ka përfitur fitim/dividend dhe nuk ka përfitur asnjë vlerë financiare ose të një natyre tjetër nga fakti se ka qenë aksioner në këtë shoqëri.

a) Burimi i krijimit janë 4,800,000 lekë të ardhura nga angazhimi në shoqërinë “****” sh.a. Në këtë shoqëri është paguar për angazhimet me të gjitha shoqëritë e lidhura për konsulencën e dhënë mbi të drejtën e autorit, çështjet ligjore që lidhen me botimet, këshillimin mbi pretendimet e subjekteve që kanë qenë objekt 4 shkrimesh në gazetë etj. Po ashtu, ka pasur dalje publike në gazetë për rubrikën e shpjegimeve të çështjeve ligjore. Bashkëlidhur vërtetimi, bilanci dhe kopje të librave të botuar në periudhën e angazhimit, për të cilat është ndjekur procesi që lidhet me të drejtën e autorit.

b) 1,300,000 lekë të ardhura nga shoqëria “****” sh.a., ku ka mbajtur edhe detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nga data 31.12.2009 dhe të kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës nga data 10.2.2010. Bashkëlidhur vërtetimi nga shoqëria dhe bilancet e shoqërisë.

c) 1,100,000 lekë nga të ardhurat nga paga në shoqërinë “****” sh.a., ku ka mbajtur detyrën e administratorit të shoqërisë nga data 22.7.2010 deri në datën 17.1.2012, me pagë mujore 80,000 lekë. Kursimet nga të ardhurat si administrator janë përdorur për të financuar blerjen e aksioneve.

d) Të ardhurat nga avokatia kryesisht të vitit 2011, statusi aktiv provohet sipas ekstraktit bashkëlidhur lëshuar nga QKB-ja.

e) Të ardhura të realizuara nga përdorimi dhe kultivimi i tokës bujqësore, administruar bashkë me familjen e tij.

f) Të ardhurat nga tokat bujqësore gjithashtu janë përfitur dhe përdorur çdo vit nga bashkëjetuesi im. Sikurse është shpjeguar më lart, e vlefshme edhe për të gjitha pyetjet që kanë lidhje me burimin e krijimit të pasurive, bashkëjetuesi ka pasur të ardhura nga burime të ndryshme nga angazhimet si i punësuar, ofrimi i shërbimeve si konsulent dhe avokat, të ardhura nga administrimi i pasurive të paluajtshme tokë bujqësore, burime të përdorura për krijimin e pasurive të tjera. Të ardhurat nga tokat bujqësore gjithashtu janë përdorur çdo vit”.

50.11 Nga hetimi⁹⁵ nuk rezultoi informacion për të ardhura të përfituara nga personi i lidhur nga shoqëritë “****” sh.a. dhe “****” sh.a., ndërsa u informuam se ka përfitur të ardhura nga paga në shoqërinë “****” sh.a. prej vitit 2010 deri në muajin shkurt të vitit 2012, me vlerë totale neto 1,273,769 lekë. Gjithashtu, personi i lidhur ka realizuar të ardhura nga fitimi neto prej aktivitetit me NIPT *** për periudhën 2010 – 2012, me vlerë totale 274,692 lekë.

50.12 Për sa i takon të ardhurave nga tokat bujqësore, personi i lidhur ose subjekti dhe nga komunikimi me institucionet gjatë hetimit nuk u arrit të provohej përfitimi i tyre. Komisioni, duke pasur mungesë provash, të cilat të vërtetonin të ardhurat nga bujqësia, nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhura nga tokat bujqësore.

50.13 Në lidhje me të ardhura të tjera të mundshme të përfituara nga personi i lidhur para fillimit të bashkëjetesës (deri në mars 2011), rezultoi nga trajtimi në pasurinë apartament në rr. “****” se subjekti kishte pamundësi financiare në këtë periudhë. Ndërsa nga analiza financiare pas fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit nuk rezultoi të jenë deklaruar kursime *cash* prej tyre, të cilat do të kishin shërbyer si burim krijimi për blerjen e aksioneve të shoqërisë në datën 11.9.2013.

50.14 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për pamundësinë financiare prej -8,303,809 lekësh në blerjen e kuotave të shoqërisë “****” sh.a. me të ardhura të ligjshme. Gjithashtu, u konstatua gjatë hetimit se subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit, pasi shoqëria në të cilën bashkëjetuesi ka qenë aksioner gjatë periudhës 2013 – 2016 ka marrë pjesë në prokurimet e fondeve publike dhe është shpallur fituese gjatë kësaj periudhe.

50.15 Subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore dhe me shpjegimet e përcjella së bashku me aktin e ekspertimit sqaron: “Në analizën financiare nuk janë përfshirë 1,300,000 lekë të ardhura nga shoqëria “****” sh.a., shoqëri në të cilën bashkëshorti ka mbajtur edhe detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës nga data 10.2.2010. Bashkëlidhur këtij prapësimi paraqesim dokumentacion shtesë administruar nga kjo shoqëri: deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.8.2024, e cila përfshin bashkëlidhur vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me nr. *** prot., datë 14.8.2024, që vërteton se shoqëria “****” sh.a. ka paguar në vitet 2010 tatim në burim në vlerën 171,850 lekë, që përfaqëson 10 për qind të tatimit të përllogaritur për t’u derdhur në buxhetin e shtetit. Nuk është e mundur të specifikohen zërat përkatës të shërbimeve apo shpenzimeve, për të cilat është paguar ky tatim, për shkak se sipas praktikës dhe legjislacionit tatimor nuk ka qenë detyrim specifikimi i zërave për të cilët paguhej tatimi në burim (pra, tatimi në burim paguhej i përbashkët për të gjithë zërat, ku shoqëria si agjent i mbajtjes së tatimit në burim ka qenë e detyruar të mbajë dhe derdhë tatimin në organet tatimore). Si rrjedhojë, këto të ardhura përmbushin të gjitha kushtet e parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës: rezulton se këto të ardhura janë realizuar nga bashkëshorti përpara se ai të fillonte bashkëjetesën me mua dhe për këto të ardhura është mbajtur dhe paguar

⁹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 21.12.2023; shkresë e ISSH-së nr. *** prot., datë 9.3.2021; shkresë nr. *** prot., datë 13.6.2024.

tatimi në burim nga shoqëria, e cila bazuar në legjislacionin në fuqi ka qenë e detyruar të mbajë dhe derdhë tatimin në burim për të ardhurat e realizuara si honorar për shërbimin e ofruar⁹⁶”.

50.15.1 Të ardhura nga shoqëria “****” sh.a. në vlerën 4,800,000 lekë, subjekti sqaron në prapësime se: *“Në këtë shoqëri, bashkëshorti është paguar për angazhimet me të gjitha shoqëritë e lidhura për konsulencën e dhënë mbi të drejtën e autorit, çështjet ligjore që lidhen me botimet, këshillimin mbi pretendimet e subjekteve që kanë qenë objekt shkrimesh në gazetë etj. për periudha disavjeçare. Bashkëlidhur paraqes dokument shtesë: Deklaratë noteriale nga shoqëria “****” sh.a., nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.8.2024. Po ashtu, bashkëlidhur deklaratës noteriale është dhe shkresa kthim përgjigjeje nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. ***, datë 20.8.2024, e cila vërteton se bilanci për vitin 2005 është depozituar dhe ka të përfshirë zërin e pagesave për të ardhurat dhe mbajtjen e tatimit në burim në rolin e agjentit tatimor. Bashkëlidhur deklaratës gjendet edhe një shkresë e vitit 2006 e DRT-së Tiranë, që provon detyrimet e papaguara të shoqërisë, ku nuk është cituar tatimi në burim si detyrim i papaguar – çka provon pagesën për vitin 2005 të tatimit në burim. Nga bilanci i depozituar dhe pranuar/administruar nga DRT-ja Tiranë rezulton se shoqëria “****” sh.a. për vitin 2005 ka kryer pagesat në zërin “honorare” dhe ka mbajtur për rrjedhojë në cilësinë e agjentit tatimor shumë përkatese. Paga e tatimit në burim paguhet pa specifikuar zërat përkates, për shkak se legjislacioni tatimor nuk kërkonte një specifikim të kësaj natyre. Nga ana tjetër, këto të ardhura, ashtu si do të analizohet më poshtë, kanë shërbyer si burim për një pasuri, e cila nuk ka ekzistuar në momentin e përpilimit të deklaratës Vetting, fakt i cili shpjegon mospasqyrimin e këtyre të ardhurave në deklaratën Vetting. Pavarësisht nga sa më sipër, Komisioni duhet të mbajë në konsideratë edhe praktikën tashmë të konsoliduar të trupave të rivlerësimit⁹⁷ se pasaktësitë në DPV-të vjetore apo në deklaratën Vetting, të pashoqëruara me mungesë burimesh financiare, nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore”.*

Vlerësimi i trupit gjykues

50.16 Komisioni çmon se u provua bindshëm se shtetasi A.M ka qenë kryetar i Këshillit Mbikëqyrës nga data 10.2.2010 deri në datën 6.5.2013, në shoqërinë “****” sh.a. Ndërsa nga pasqyrat financiare të shoqërisë “****” sh.a. vërtetohet se zëri “shpenzime të tjera” është në vlerën 4,715,505 lekë dhe nga llogaria analitike e saj shihet se nënzëri “honorare” është me vlerë 1,718,462 lekë. Pra, rezultoi se kjo shumë është e mjaftueshme për mbulimin e pagesës së tatimit mbi vlerën e përfituar nga personi i lidhur dhe gjithashtu u konfirmua nga organet tatimore se shoqëria ka shlyer të gjithë vlerën e tatimit në burim për vitin 2010, e nuk ka detyrim të pashlyer për këtë vit. Trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e personit të lidhur në këtë shoqëri do të përfshihen në analizën e përditësuar të Komisionit.

50.17 Ndërsa për të ardhurat e përfituara në shoqërinë “****” sh.a. nga shpjegimet e subjektit deklarohet se shtetasi A.M ka qenë konsulent në këtë shoqëri gjatë viteve 2004 – 2006, ndërsa shpërblimi i është dhënë në vitin 2005. Subjekti, ashtu si edhe më lart, sqaron se në zërin “Trajtime dhe shpërblime të tjera”, me vlerë 20,054,666 lekë, është mbajtur edhe tatimi në burim për të

⁹⁶ Edhe në këtë drejtim jurisprudenca e trupave të rivlerësimit është e konsoliduar, p.sh. shihni vendimin e formës së prerë të Komisionit nr. 389, më 20.5.2021.

⁹⁷ Në vendimin nr. 10/2022, Kolegji arsyeton se: “25.6. Lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë Vetting nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, të llogarisë së përbashkët bankare me vëllain e saj, Kolegji vlerëson se subjekti i rivlerësimit ndodhet përpara deklarimit të pasaktë, jo në përputhje me nenin 33, pika 5, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, por kjo pasaktësi nuk shoqërohet me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për shumat e depozituara prej saj në këtë llogari, sipas analizës financiare të kryer në Komision dhe në Kolegj e, për këtë shkak, për subjektin e rivlerësimit nuk mund të aplikohet neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

ardhurat e përfituara prej saj. Subjekti nuk arriti të provojë marrëdhënien e punës me shoqërinë “****” sh.a. Trupi gjykues vlerësoi se subjekti nuk arriti të provojë gjithashtu shlyerjen e detyrimeve tatimore për shumën e përfutur, prandaj kjo vlerë nuk do të përfshihet në analizën financiare të përditësuar.

50.18 Shumat e të ardhurave të tjera të deklaruara si burim krijimi nga subjekti janë trajtuar më lart në këtë vendim⁹⁸. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti ka pamundësi në krijimin e vlerës së blerjes së aksioneve në shumën totale -8,303,809 lekë, pasi personi i lidhur nuk ka deklaruar gjendje kursimesh *cash* në fund të vitit 2012, të cilat mund të ishin krijuar nga të ardhurat e tij para fillimit të bashkëjetesës dhe të shërbenin për blerjen e aksioneve në këtë shoqëri.

51. Ortak i vetëm themelues i shoqërisë “**” sh.p.k.**, me NIPT ***, me kapital 100,000 lekë. *Kam transferuar 50% të pjesëmarrjes në shoqëri tek z. A.K me vlerë 50,000 lekë, sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2011. Transferuar me kontratën nr. *** rep., *** kol., datë 3.12.2013, tek znj. I.S. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia (kapitali nuk u shlye asnjëherë, pasi ligji e lejon). Pjesa takuese: 100%.*

Hetimi/analiza financiare e kryer nga Komisioni

51.1 Në DIPP-në e vitit 2014, bashkëjetuesi ka deklaruar pjesëmarrjen në shoqëri dhe shitjen e aksioneve në këtë shoqëri.

51.2 QKB-ja⁹⁹ konfirmoi se shtetasi A.M rezultoi të ketë qenë administrator i larguar në datën 23.7.2017 dhe ortak zotërues i 50% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., me NIPT ***, me kapital prej 100,000 lekësh. Shoqëria është regjistruar në datën 21.10.2010 dhe ka status aktiv, me objekt veprimtarie “konsulencë në fusha të ndryshme”. Aktualisht ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë është znj. I.S. Rezultoi se kjo shoqëri ka ndryshuar emrin në datën 24.8.2011 nga “****” në “****” dhe me kontratë shitblerjeje të kuotave nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.9.2011, i është shitur 50% e aksioneve shtetasit A.K me vlerë 50,000 lekë. Ndërsa me kontratë shitjeje datë 21.7.2015 personi i lidhur rezultoi t’ia ketë shitur kuotat e veta në shoqëri shtetases I.S me çmim 50,000 lekë.

51.3 Nga hetimi¹⁰⁰ rezultoi se shtetasi A.M figuron në listën e pagamarrësve pranë shoqërisë “****” sh.p.k., me shumë totale të ardhurash neto për vitet 2012 – 2013 prej 539,133 lekësh.

51.4 Komisioni hetoi¹⁰¹ nëse ekzistonte konflikt interesi i subjektit për shkak të detyrës me shtetasit e sipërpërmendur dhe shoqërinë “****” dhe rezultoi se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale që kanë lidhje me këta shtetas dhe shoqëri.

51.5 Në lidhje me burimin e krijimit, personi i lidhur deklaroi se nuk është shlyer kapitali. Megjithatë, Komisioni konstaton se edhe në rast se do të ishte shlyer kapitali total me vlerë 100,000 lekë, nga analiza financiare e vitit 2011 rezultoi se personi i lidhur dhe subjekti do të kishin mundësi për të krijuar vlerën e kapitalit me të ardhura të ligjshme.

Vlerësimi i trupit gjykues

⁹⁸ Shihni burimet e trajtuara për derdhjen e kapitalit të shoqërisë “****” sh.a.

⁹⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.3.2021.

¹⁰⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 8.3.2021.

¹⁰¹ Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023, nr. *** prot., datë 4.12.2023 dhe nr. *** prot., datë 12.6.2024.

51.6 Sa më lart, trupi gjykues çmon se nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

GJETJE TË TJERA

52. Komisioni konstaton se në DIPP-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar kontratë prenotimi apartamenti nr. * rep., nr. *** kol., datë 14.11.2017, lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k. Vlera totale: 52,249 euro. Burimi i krijimit: Paguar kësti i parë nga të ardhurat nga shitja e apartamentit sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2017, në vlerën 78,000 euro. Kësti i dytë prej 22,249 euro, i pashlyer.**

52.1 Gjithashtu, subjekti deklaroi edhe shitjen e apartamentit me sip. 85 m², pasuria nr. ***, z. k. ***, rruga “****”, sipas kontratës së shitjes me kusht nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2017, para noterit A.H në vlerën 78,000 euro.¹⁰²

52.2 Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti në datën 21.1.2021 deklaroi: “...pasi kemi shitur banesën tonë në rrugën “****”, pallati ***, me kontratë sipërmarrjeje kemi prenotuar/porositur një apartament në rrugën “****” nga shoqëria “****” sh.p.k. (investitor), në shumën 52,249 euro. Në kushtet kur ne u vumë në dijeni për këtë okazion në këtë kompleks, kemi nxjerrë në shitje banesën tonë dhe me kontratën e prenotimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2017, kemi blerë këtë apartament, objekti i cili ishte në fazë karabina. Nuk e kemi marrë në posedim dhe kemi mbi 3 vjet që jemi në shtëpi me qira, pasi apartamenti dhe godina ende nuk kanë përfunduar, shoqëria ndërtuese ka shtyrë me dy vite lejen e ndërtimit dhe vijohet të punohet (ortakët ndërtues të këtij objekti kanë mosmarrëveshje mes tyre, gjyqësore dhe konflikte, dhe kjo ka ndikuar në vonesat e shkaktuara, për të cilat vijojmë të mos marrim në pronësi dhe posedim apartamentin. Nuk e kemi shlyer të gjithë shumën e rënë dakord, por vetëm shumën prej 30,000 euro (kjo shumë ka kaluar me transaksion bankar nga shitja e banesës sonë në rrugën “****”, ku një pjesë e shumës shkoi për të paguar kredinë në bankën Intesa Sanpaolo, pjesa tjetër kaloi për të paguar këstin e këtij apartamenti), pasi objekti ende nuk ka përfunduar dhe pagesa do kryhet pas përfundimit të objektit”. Subjekti bashkëlidh praktikën e kontratës së prenotimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2017 dhe veprimet në bankë të kryera në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

52.3 Nga kopja e kontratës së prenotimit të apartamentit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2017, rezultoi se porositorit A.M dhe Ornela Rrumbullaku kanë prenotuar një apartament pranë sipërmarrësit, shoqërisë “****” sh.p.k., në objektin që shoqëria “****” sh.p.k. po ndërton në Tiranë. Shoqëria “****” sh.p.k. ka përfunduar apartamentin me sipërfaqe totale dhe të hipotekuar prej 106.91 m², të cilin ka rënë dakord t’ua shesë shtetasve A.M dhe Ornela Rrumbullaku në çmimin 52,249 euro. Sipas kësaj kontrate, kësti i parë prej 30,000 euro do të likuidohet me nënshkrimin e kësaj kontrate nëpërmjet bankës. Pjesa tjetër prej 22,249 euro do të likuidohet me marrëveshje midis palëve deri në dorëzimin e çelësave të apartamentit nëpërmjet kredisë bankare.

52.4 Prej Intesa Sanpaolo Bank¹⁰³ u konfirmua se në datën 13.11.2017 transferohet në llogarinë e subjektit nga llogaria e noterit A.H shuma 33,000 euro, me përshkrimin “Kalim i këstit të dytë përfundimtar për shitblerje shtëpie sipas kontratës nr. *** rep., *** kol”. Rezultoi se shtetasi A.M ka tërhequr *cash* në datën 14.11.2017 shumën 30,000 euro, me përshkrimin “Tërheqje për blerje

¹⁰² Komisioni kërkoi informacion nga shoqëria “****” sh.p.k. me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2023, e cila është pa përgjigje (arsyeja: ka ndryshuar adresë).

¹⁰³ Shkresë e Intesa Sanpaolo nr. ***, datë 25.3.2021.

apartamenti sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2017”. Ndërsa nga kopja e mandatit bankar të Raiffeisen Bank¹⁰⁴ u konfirmua veprimi i depozitimit të shumës 30,000 euro në datën 14.11.2017, në llogarinë e shoqërisë “****” sh.p.k., me përshkrimin “A.M, pagim kësti I për blerje apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2017.”

Gjithashtu u konfirmua edhe transferimi i këstit të parë nga shitja e apartamentit në adresën “****”, në datën 16.10.2017, me vlerë 5,998,500 lekë, me përshkrimin “Pagesë sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2017, kësti i parë”, i cili përdoret për të shlyer kredinë e marrë pranë ISP bank në vitin 2017.

52.5 Noteri publik A.M¹⁰⁵ konfirmoi veprimin noterial të kontratës së prenotimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 14.11.2017 dhe noteri A.H¹⁰⁶ konfirmoi veprimin noterial të kontratës së shitjes me rezervë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.10.2017.

52.6 Gjithashtu, Komisioni iu drejtua sërish noterit publik A.M (K)¹⁰⁷, për të përcjellë kopje të çdo dokumenti të firmosur prej shtetasit A.M pranë zyrës së saj dhe na përcillet edhe prokura e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol. datë 8.10.2019, me anë të së cilës shtetasit A.M, Ornela Rrumbullaku dhe të tjerë emërojnë përfaqësues të tyre shtetasin S.LL për kryerjen e procedurave të nevojshme për të aplikuar online, për të marrë lejen e nevojshme për punimet e ndryshme, pasi midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe shtetasve A.M dhe Ornela Rrumbullaku është nënshkruar një kontratë prenotimi nr. *** rep., nr.*** kol., datë 14.11.2017, për apartamentin nr. ***, sip. totale 121.77 m².

52.7 Rezultoi¹⁰⁸ se shtetasi A.M ka lidhur kontratë qiraje (jo noteriale), datë 20.12.2017, me shtetasin G.B për marrjen me qira të një apartamenti të ndodhur në kompleksin “****”, rr. “****”, me sip. 66.93 m², me vlerë qiraje 22,000 lekë/muaj dhe afat kontrate 1 vit. Nga kontrata rezultoi se qiradhënësi është dhe pronar truall në këtë projekt, ka lidhur kontratë shtesë të sipërfaqeve për pjesët (pronar truall/firmë ndërtimi) nr. *** rep., datë 18.2.2016, me shoqërinë investitore “****” sh.p.k. Ndërsa përcillet edhe rinovimi i kontratës së qirasë në datën 20.12.2018, me afat njëvjeçar. Nga llogaria e shtetasit A.M pranë Raiffeisen Bank rezultoi të jetë transferuar shuma e qirasë 22,000 lekë/muaj për shtetasin G.B prej datës 10.6.2019 e deri në kthimpërgjigjen e bankës (shkurt 2021).

52.8 Komisioni hetoi në lidhje me konfliktin e interesit¹⁰⁹ dhe rezultoi se subjekti gjatë kohës së ushtrimit të detyrës nuk ka shqyrtuar çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë dhe shtetasit e mësipërm.

52.9 Sa më lart, rezultoi për çmimin e blerjes së apartamentit se:

52.9.1 Me përgjigjen e noterit publik bashkëlidhet kopje kontrate prenotimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 19.12.2015, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës porositëse A.L, për apartamentin nr. ***, me sipërfaqe totale 90.38 m², sipërfaqe të hipotekueshme 79.35 m², kati i katërt banimi, me çmim total 7,000,000 lekë. Pra, çmimi për m² i këtij apartamenti të ndodhur në të njëjtën strukturë ndërtimore (identifikuar nga leja e ndërtimit) me apartamentin e porositur nga subjekti dhe bashkëshorti është 88,217 lekë/m² për sipërfaqen e hipotekueshme.

¹⁰⁴ Bashkëlidhur kontratës, në përgjigjen e noteres A.M.

¹⁰⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2023.

¹⁰⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 30.10.2023.

¹⁰⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2024.

¹⁰⁸ Bashkëlidhur pyetësorit standard.

¹⁰⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 12.6.2024.

52.9.2 Nga kopja e kontratës¹¹⁰ së prenotimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.12.2017, lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. dhe palës porositëse M.XH, për apartamentin nr. ***, kati i *** i banimit, me sipërfaqe totale 125.18 m², rezultoi 109.9 m² sipërfaqe e hipotekueshme, me çmim në total 81,350 euro ~ 10,815,483 lekë¹¹¹. Edhe ky apartament ndodhet në të njëjtën strukturë ndërtimore (identifikuar nga leja e ndërtimit) me apartamentin e porositur nga subjekti dhe bashkëshorti dhe çmimi për m² për sipërfaqe të hipotekueshme llogaritet prej 740,37 euro/m² ~ 98,433¹¹² lekë/m².

52.9.3 Referuar vlerës së tregut të lirë të shitjes së apartamenteve nga EKB-ja¹¹³ për vitin 2016, në zonën (***) ku ndodhet apartamenti, çmimi i referencës është 85,000 lekë/m² (~ 628.37¹¹⁴ lekë/m²) për sipërfaqe të shfrytëzueshme/të hipotekueshme. Pra, vlera totale e apartamentit e porositur nga subjekti me këtë çmim reference do të ishte 9,087,350 lekë (85,000 lekë/m²*106.91 m²).

52.9.4 Në konkluzion të sa më lart, rezultoi se subjekti e ka porositur apartamentin me sipërfaqe totale dhe të hipotekueshme prej 106.91 m² në vlerën totale 52,249 euro (~6,946,505¹¹⁵ lekë) ose 488.7 euro/m² (~ 64,975¹¹⁶ lekë/m²). U konstatua gjatë hetimit se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj e kanë blerë apartamentin me një çmim më të ulët krahasuar me kontratat e apartamenteve të ngjashme të shitura në të njëjtën strukturë ndërtimore. Edhe krahasuar me çmimet e referencës rezultoi se ky apartament është blerë rreth 0.31 herë më lirë nga subjekti i rivlerësimit.

52.9.5 Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me çmimin favorizues në dukje të rezultuar nga hetimi për apartamentin e blerë prej shoqërisë “****” sh.p.k.

52.9.6 Subjekti i rivlerësimit pas dhënies së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore sqaroi se: *“Lidhur me kontratën me shoqërinë “****” sh.p.k. ...Në përcaktimin e çmimit ka ndikuar njohja personale e bashkëshortit me ortakun e shoqërisë, njëkohësisht dhe administrator i saj dhe vlerësimit të tij se blerja do të finançohej me të ardhurat e shitjes së shtëpisë së banimit dhe shoqërohej me kosto për pagesë qiraje deri në dorëzimin e apartamentit. Shoqëria ishte në përfundim të kryerjes së pjesës së saj të investimit dhe kishin ngelur disa njësi për shitje, kishte nevojë për likuiditete në bankë, dhe kësti i parë ishte relativisht i lartë. Rezulton se kjo shoqëri ka aplikuar çmime të ndryshme dhe më të ulëta për klientë të ndryshëm. Shoqëria ka vënë në dispozicion me kërkesë të bashkëshortit kopje të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 5.4.2018 dhe kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.1.2019, për dy klientë të tjerë, për të cilët janë aplikuar çmime të përafërta. Për një vlerësim shterues dhe tërësor mbi kontratën me shoqërinë “****” sh.p.k., duhet të mbahet në konsideratë se nuk është përfunduar kalimi i pronësisë për shkak të mospajisjes së shoqërisë me certifikatë pronësie dhe konflikteve mes investitorëve, që kanë sjellë disa vite vonesë në raport me lejen e ndërtimit. Nga ana tjetër, nga prenotimi dhe shitja e shtëpisë së banimit, kemi qëndruar me qira deri në korrik të vitit 2023, kosto shtesë kjo që ka shoqëruar kontratën e prenotimit dhe që duhet të mbahet në konsideratë për vlerësimin e çmimit. Pra, në tërësi prenotimi ka pasur kosto shtesë dhe, nëse nuk do të ishte çmimi i rënë dakord, nuk kishte*

¹¹⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2024.

¹¹¹ BOA kursi mesatar euro/ALL =132,95.

¹¹² BOA kursi mesatar euro/ALL =132,95.

¹¹³ Udhëzim nr. 3, datë 28.12.2016 <https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/UKM-nr.3-date-28.12.2016.pdf>

¹¹⁴ BOA kursi mesatar euro/ALL viti 2016 =135,27.

¹¹⁵ BOA kursi mesatar euro/ALL =132,95.

¹¹⁶ BOA kursi mesatar euro/ALL =132,95.

arsye për të shitur shtëpinë dhe prenotuar një shtëpi në objekt në ndërtim e sipër.” Subjekti bashkëlidh me shpjegimet kopje të kontratave të pasurive të ngjashme në këtë godinë banimi, të lidhura nga palë të ndryshme me shoqërinë “****” sh.p.k., nga të cilat rezultoi se çmimi i shitjes së tyre është përafërsisht sa çmimi i blerjes nga ana e personit të lidhur dhe subjektit të rivlerësimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

52.9.7 Trupi gjykues çmon se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe të mbështetura në prova. Nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë pasuri për procesin e rivlerësimit të subjektit.

53. Komisioni konstaton nga hetimi¹¹⁷ se shtetasi A.M ka lidhur kontratë prenotimi apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2015, me shoqërinë “****” sh.p.k. për apartamentin nr. ***, shkalla ***, me sipërfaqe totale 74 m², sip. të përbashkët 8.6 m², në K, Tiranë. Në kontratë parashikohet se pala porositëse ka marrë përsipër t’i paguajë sipërmarrësit për apartamentin vlerën e plotë të këtij apartamenti të porositur prej tij. Kjo pagesë është kryer jashtë zyrës së noterit.

53.1 Subjekti dhe personi i lidhur nuk e deklarojnë këtë pasuri në deklaratat periodike dhe as në deklaratën e pasurisë. Gjithashtu edhe nga institucionet¹¹⁸ nuk u konfirmua pasuria si më lart e lidhur me subjektin dhe/ose personin e lidhur.

53.2 Komisioni, për të saktësuar të dhënat në lidhje me pasurinë sa më sipër, iu drejtua shoqërisë “****”¹¹⁹ sh.p.k. për informacion të shoqëruar me dokumentacion lidhur me shumën, periudhën e pagesave të kryera, mënyrën e likuidimit të tyre nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj. Shoqëria na informoi se: “Z. A.M ka qenë përfaqësues ligjor (avokat) i shoqërisë në një proces gjyqësor administrativ me objekt pavlefshmëri detyrimesh dhe gjobash lidhur me një procedurë rivlerësimi detyrimesh, me palë të paditur DRT-në T dhe DPT-në dhe ka ofruar konsulencë për shoqërinë për një periudhë kohe. Në kushtet që kishim një marrëdhënie konsulente në datën 23.1.2015 mes palëve, është lidhur kontratë prenotimi apartamenti në objektin që ndërtohej sipas lejes së ndërtimit nr. ***, datë 18.11.2006, ish-komuna Kr, Tiranë, konkretisht me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2025, notere A.M (K). Në dijeninë tonë, z. M kërkonte një apartament për familjarë të tij, por u firmos nga ai. Për këtë apartament nuk u krye asnjë pagesë nga z. A.M, persona të lidhur me të ose të caktuar prej tij, as nëpërmjet sistemit bankar, as në arkën e shoqërisë. Kontrata parashikoi mundësinë edhe të pagesës edhe jashtë zyrës noteriale, por ajo nuk u pagua. Në këto kushte, duke qenë se pagesa është elementi thelbësor i një kontrate, palët në datën 2.11.2015 brenda të njëjtit vit dhe tek e njëjta notere nënshkruan deklaratë për revokim kontrate, sipas aktit noterial nr. *** rep., nr. *** kol.”

53.3 Bashkëlidhur shkresës së shoqërisë përcillet kontratë prenotimi apartamenti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2015, me notere znj. A.M (K), me palë sipërmarrëse shoqërinë “****” sh.p.k. dhe palë porositëse z. A.M. Gjithashtu, përcillet edhe deklaratë për revokim kontrate nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2015, me notere znj. A.M (K), ku deklaruesit A.M dhe shoqëria “****” sh.p.k. deklarojnë: “Të sipërpërmendurit deklarojnë se më mirëkuptimin e plotë të tyre e anulojnë kontratën e mësipërme të prenotimit. Gjithashtu, ata deklarojnë se përpara nënshkrimit të këtij revokimi shoqëria i ka likuiduar çdo detyrim z. A.M dhe midis tyre nuk ka detyrime të ndërsjella.

¹¹⁷ Shkresë e RNSH-së nr. ***, datë 1.3.2021 dhe nr. *** prot., datë 2.11.2023.

¹¹⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 19.3.2021; shkresë nr. *** prot., datë 24.3.2021; shkresë e UKT-së nr. ** prot., datë 4.3.2021; shkresë e FSHU-së nr. *** prot., datë 11.3.2024.

¹¹⁹ Shkresë e shoqërisë “****” sh.p.k. nr. *** prot., datë 12.12.2023.

*Apartamenti i mbetet përsipër shoqërisë “***” sh.p.k., së cilës i lind e drejta që këtë apartament t’ia kalojë një pale të tretë.”*

53.4 Nga RNSH-ja¹²⁰ dhe komunikimet me institucionet¹²¹ Komisioni u informua se veprimi juridik i prenotimit të apartamentit është i regjistruar në sistemin e regjistrimit noterial. Ndërsa nuk rezultoi të ketë raportime për deklaratën e revokimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2015. Komisioni vijoi me hetimin, duke i kërkuar noterit publik A.M (K) të përcjellë kopje të çdo dokumenti të firmosur prej shtetasit A.M pranë zyrës së saj dhe kopje të regjistrimit noterial, ku është regjistruar veprimi juridik i revokimit. Noterja me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2024, përcjell kopje të dokumentacionit si më lart, duke përfshirë edhe kopje të faqes së regjistrimit noterial, ku është regjistruar deklarata e revokimit nr. *** rep., nr. *** kol. datë 2.11.2015.

53.5 Komisioni¹²² hetoi në lidhje me konfliktin e interesit dhe rezultoi se subjekti gjatë kohës së ushtrimit të detyrës nuk ka shqyrtuar çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë “***” sh.p.k. dhe/ose administratorët e saj.

53.6 Në lidhje me burimin e krijimit të vlerës 22,000 euro dhe pagesën e çmimit të blerjes:

53.6.1 Nga hetimi rezultoi se në kontratën e prenotimit për apartamentin nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2015, lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k. për pagesën e vlerës së apartamentit citohet: *“Në kontratë parashikohet se pala porositëse ka marrë përsipër t’i paguajë sipërmarrësit për apartamentin shumën 22,000 euro ose 3,080,000 lekë, vlerën e plotë të këtij apartamenti të porositur prej tij. Kjo pagesë është kryer jashtë zyrës së noterit.”*

53.6.2 Ndërsa në deklaratën e revokimit të kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2015, citohet: *“Gjithashtu, ata deklarojnë se përpara nënshkrimit të këtij revokimi shoqëria i ka likuiduar çdo detyrim z. A.M dhe midis tyre nuk ka detyrime të ndërsjella”.*

53.7 Komisioni, duke u mbështetur në përmbajtjen e veprimeve juridike të rezultuara gjatë hetimit, konstatoi se midis palëve ka pasur transaksione të shkëmbimit të vlerave monetare për këtë apartament. Në vijim, u hetua në lidhje me mundësinë e personit të lidhur për të krijuar vlerën 22,000 euro në janar 2015, nga e cila rezultoi se personi i lidhur nuk ka pasur mundësi të krijojë vlerën e blerjes me të ardhura të ligjshme.

53.8 Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për pamundësinë financiare për blerjen e apartamentit në shumën -3,080,000 lekë. Gjithashtu, subjekti duhet të provonte marrëdhënien e përfaqësimit/konsulencës nga personi i lidhur me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe administratorin A.D.

53.9 Subjekti i rivlerësimit pas dhënies së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore sqaroi: *“Sikurse rezulton nga dokumentacioni i mbajtur nga shoqëria, bashkëshorti ka nënshkruar prenotimin e apartamentit, por nuk ka kryer asnjë pagesë dhe, për rrjedhojë, nuk ka burim për të vërtetuar këtë kontratë. Apartamenti i përshkruar në kontratën e nënshkruar nga bashkëshorti pas zgjidhjes së kontratës, ashtu sikurse vërtetohet nga dokumentacioni bashkëlidhur kësaj kontrate, i është shitur një shtetasi tjetër. Për të vërtetuar këtë fakt, bashkëlidhur gjendet deklarata noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.8.2024, e shoqërisë “***” sh.p.k., me dokumentacionin e mbajtur nga kjo shoqëri lidhur me apartamentin objekt kontrate: a) kontratë prenotimi nr. *** rep., nr. *** kol., datë 2.11.2015, me palë porositëse L. Y.; - mandatpagesë në Alpha Bank sh.a.*

¹²⁰ Shkresë e Ministrisë së Drejtësisë nr. ***, datë 1.3.2021.

¹²¹ Aneks ***.

¹²² Shkresë nr. *** prot., datë 23.11.2023 dhe nr. *** prot., datë 4.12.2023.

të shumës së paguar nga shtetasja L. Y. për shoqërinë “***” sh.p.k. për prenotimin e apartamentit; b) kontratë shitjeje pasurie e paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.11.2015, me blerës shtetasen L. Y. dhe shitës shoqërinë “***” sh.p.k.; c) kontratën e lidhur me bashkëshortin dhe deklaratën e zgjidhjes së kontratës.”

53.10 Subjekti shpjegon për marrëdhënien e personit të lidhur me të me shoqërinë “***” sh.p.k. se: “Lidhja e kontratës me shoqërinë “***” sh.p.k. është bërë në kushtet që mes bashkëshortit dhe shoqërisë ka pasur marrëdhënie shërbimi për një kohë të gjatë dhe të konsoliduar mes klientit dhe avokatit, lidhur me çështjen administrative, me paditës shoqërinë “***” sh.p.k. dhe të paditur Drejtorinë Rajonale Tatimore, proces gjyqësor që ka zgjatur disa vite. Si dokument shtesë gjendet vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, proces i kryer gjatë vitit 2013, gjykuar në Gjykatën e Apelit në vitin 2014 dhe lënë në fuqi në Gjykatën e Apelit Administrativ po në vitin 2014. Pra, ka qenë një marrëdhënie në vijimësi përfaqësimi, por edhe konsulence në disa raste për çështje të ndryshme të shoqërisë, dhe midis bashkëshortit e shoqërisë ka pasur marrëdhënie mirëbesimi. Për shkak të marrëdhënies së mirëbesimit të krijuar u lidh kontrata dhe nuk u krye asnjë pagesë për disa muaj. Më pas, për shkak se nuk u krye pagesa, shoqëria kishte kërkesa për blerjen e apartamentit, palët ranë dakord që kontrata të zgjidhej dhe t’i krijohej mundësia shoqërisë të krijonte të ardhura nga një njësi, e cila nuk kishte krijuar asnjë të ardhur për të deri në atë moment. Në këtë periudhë, shoqëria kishte nevojë për likuiditete dhe qëllimi i saj ishte të realizonte të ardhura. Në kushtet që nuk po krijonte të ardhura nga kjo njësi banimi, u shit te një blerës që rezultoi nga dokumentacioni i shoqërisë që ka paguar menjëherë në bankë.”

Vlerësimi i trupit gjykues

53.11 Trupi gjykues çmon se subjekti arriti të shpjegojë në mënyrë shteruese se për apartamentin e mësipërm ishte shlyer në total shuma e çmimit të blerjes dhe ishte regjistruar veprimi juridik i blerjes prej personave të tretë dhe jo nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues vlerëson se çmimi i blerjes së apartamentit duhet të mos përfshihet në analizën e përditësuar të Komisionit, pasi u provua bindshëm se personi i lidhur nuk ka kryer pagesë për këtë apartament dhe as nuk e zotëron atë.

54. Analiza financiare tetor 2006 – 2016

54.1 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara, u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurorë privatë/vjetorë, deklaratën *Vetting*, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

54.2 Në konkludim të sa më sipër, Komisioni hartoi analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën tetor 2006 – 2016, e cila rezultoi me pamundësi në vlerën totale -53,829,092 lekë, kryesisht prej investimeve të kryera prej bashkëjetuesit të saj në vitet 2013 – 2015. Komisioni i kaloi barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 mbi pamundësinë financiare të rezultuar gjatë hetimit.

Vlerësimi i trupit gjykues

54.3 Pasi vlerësoi shpjegimet dhe provat e depozituara prej subjektit, Komisioni arriti në konkluzionin se ato kanë nivel besueshmërie dhe provueshmërie të pamjaftueshëm. Këto vlerësime të Komisionit, të trajtuara gjerësisht më lart, u reflektuan në analizën financiare, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pamundësi financiare në vlerën totale -5,519,258 lekë, specifikisht në vitet 2013 – 2014.

55. Konkluzion për kriterin e kontrollit të pasurisë

55.1 Në përfundim të këtij hetimi administrativ, Komisioni çmon se në vendimmarrjen e tij përfundimtare, siç konstatohet edhe më lart, duhet të marrë në konsideratë si vijon:

55.2 Subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

55.3 Subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në vlerën totale -5,519,258 lekë për krijimin e pasurive, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të saj dhe të personit të lidhur.

55.4 Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ornela Rrumbullaku nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

ANALIZA FINANCIARE TETOR 2009 – 2016

Përshkrimi	Para marrjes së detyrës	tetor - dhjetor 2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	284,889	198,388	446,448	-402,858	362,736	-101,242	15,247,199	-3,925	4,921,400	3,313,343	260,343	494,278
Makinë Opel, Burimi i krijimit: Pjesëtimet burimore si dhe kredi konsumatore në Banka K* T* Sh.A. në shumën 300,000 lekë disburuar në datë 23.4.2007.			500,000									
Apartamenti me inpasurie * z.k., ruga "I* T*", T*. Sip. 85 m2, blerë me kontratë sipërmarje nr.*rep dhe nr.* kol, dt. 11.01.2011. Apartamenti është i regjistruar në emër të shoqërisë "G*" sh.p.k dhe është kolateral për kredinë e marrë për blerje apartamenti në "T*" Bank S.H.A në shumën 46,000 euro. Burimi i krijimit: Të ardhurat nga Personi Fizik "A* M*", bilanci i personit fizik është paguar në bankë për marrje kredie.							10,697,505					
Tokë arë me sip. totale 16,900 m2 (pasuria nr. * sip. 12,430 m2; nr. * me sip. 600 m2, nga të cilat 200 m2 imall dhe ndërrim 93 m2, nr. * me sip. 3,600 m2). Pasuria ndodhet në B.P. L*. Burimi i krijimit: Ligji nr.7501/1991 dhe trashëgimia nga babai, në bashkëpunësi ideale me familjen bujqësore me kryefamiljare V* M*. Pjesa takuese: 30%.											35,000	
Makinë "Volksvagen Passat", blerë me kontratë blerje nr. * rep dhe * kol, dt. 7.3.2010. Burimi i krijimit: të ardhurat e mia (bashkëjetuesit) para bashkëjetësës.							1,383,000					
Vlera: 10,000 euro												
Kuota në shoqërinë "G*" sh.p.k Burimi i krijimit: të ardhurat e mia; Kam blerë 50% të pjesëmarrjes në shumën 50,000 lekë dhe kam shitur 15% të pjesëmarrjes në shumën 15,000 lekë. Vlera 100,000 lekë. Pjesa takuese: 58%.												
Kuota në shoqërinë "I*P*" sh.p.k. Burimi i krijimit: të ardhurat e mia (kapitali nuk është shlyer). Blerë nga R* B* me kontratë nr.* kol, dt. 4.9.2012. Vlera 100,000 lekë								100				
Aksione në "I* P* V* D* S*" Sh.a, Person juridik i regjistruar në 15.9.2014. Burimi i krijimit: të ardhurat e mia para bashkëjetësës.										3,300,000		
Aksione në shoqërinë "T*" S.H.A. Burimi i krijimit: Nuk është paguar pjesa e kapitalit. Shoqëria nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar për mangësi të bazës ligjore për licencim (nuk është licencuar).												
Aksione në shoqërinë "Z*P*" S.H.A. Burimi i krijimit: Nuk është paguar pjesa e kapitalit. Shoqëria nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar për mangësi të bazës ligjore për licencim (nuk është licencuar).												
Onak (vetëmirëmbajtje) shoqërië "K*" sh.p.k, me kapital 100,000 lekë. Kam transferuar 50% të pjesëmarrjes në shoqëri tek z.A* K* me vlerë 50,000 lekë, sipas kontratës nr.* rep, nr.* kol, dt. 1.09.2011. Transferuar me kontratë nr. * rep, * kol, dt. 3.12.2013 tek z.J* S*. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia (kapitali nuk u shlye asnjëherë pasi ligji e lejoi).							100					
Aksione në "R* T*" sh.a me adresë IP. Zotëron 30,000 aksione blerë sipas kontratës nr. * rep, dhe nr.* kol, dt. 11.09.2013. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia. Vlera 30,000 aksione me vlerë 49,980,000 lekë. Pjesa takuese: 30%.									8,303,809			
Blerje e apartamenti me kontratë nr.* rep., nr.* kol, dt. 23.01.2015 me shoqërinë "H*"sh.p.k, me sipërfaqe totale 74 m2, të ndodhur në K*, T*.												
Shtesa pakësime bliditete në bankë dhe CASH	284,889	198,388	-53,552	-402,858	362,736	-101,242	3,166,604	-4,025	-3,382,499	13,343	225,343	494,278
Total likuiditete	284,889	483,278	429,723	26,867	389,603	288,362	3,454,956	3,450,930	68,521	81,864	307,207	801,485
DETYRIME	0	0	207,160	-152,628	628,318	1,532,842	5,549,801	-560,307	-516,908	-561,470	-525,376	-544,463
Kredia bankare pranë T* Bank sh.a për blerje apartamenti												
Kredi konsumatore pranë B* dt. 23.04.2007, vlera 300,000 lekë përdorur për blerje automjeti			207,160	-152,628	-57,532		5,668,226	-572,852	-533,499	-561,561	-553,353	-543,493
Kredi konsumatore pranë U* Bank shuma 150,000 lekë						144,742		-118,425				
Kredi e kumates pranë A* Bank në vlerën 5,000 euro dhe 10,000 euro në 2010						685,850	1,388,100					
Kartë krediti në U* Bank e subjektit me limit 500 euro								12,545	16,591	91	27,977	970
PASURINETO	284,889	198,388	239,287	-250,230	-265,582	-1,634,083	9,697,398	556,381	5,438,308	3,874,812	785,719	1,038,741
TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA	2,254,728	881,173	2,084,069	2,737,212	2,904,782	3,277,584	11,655,784	2,197,567	2,841,871	2,075,071	1,990,923	3,311,505
Të ardhura të subjektit nga Shkolla e Magjistruarës, bursë	936,090	183,056										
Të ardhura të subjektit nga Shkolla e Magjistruarës honorare										10,800	14,745	
Të ardhura të subjektit nga paga neto nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë		192,306	832,164									
Të ardhura të subjektit nga paga nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë				1,040,931	870,045	850,484	905,370	933,386	1,043,157	884,855	574,550	1,188,393
Të ardhura të subjektit nga INSH -leje lindje										130,030	446,628	
Të ardhura nga paga e nënës së subjektit transferuar në R* bank	342,284	85,601	307,184	373,393	390,417	399,374	98,107					
Të ardhura nga paga e vëllait të subjektit (transferuar në B*Bank-U*bank-R*bank)	475,942	374,718	715,365	821,312	815,537	1,197,758	193,863					
Të ardhura nga paga kumata e subjektit (O*/A*Bank)												
Të ardhura nga pensioni babait të subjektit	500,412	45,492	181,968	181,968	181,968	181,968	162,000					
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare			2,010									
Të ardhura nga paga B* P* sh.a							632,904	185,894				
Të ardhura nga paga A* P* M*							128,080					
Të ardhura nga paga S* P* Q* sh.a								481,448				
Të ardhura nga paga në shoqërinë "S* T"							192,120					
Të ardhura nga paga K* C*							85,525	441,679	97,454			
Të ardhura nga pampagimi prej z. K* L*, nga "Kontratë Shërbimi" datë 30.4.2013 shuma 10,000 euro.									1,402,100			
Të ardhura si anëtar i Këshillit Mbikqyrës së Shoqërisë "V* A*" sh.p.k, shuma 80,000 lekë												80,000
Të ardhura neto nga personi fizik "A* M*" me NIPT L*										840,386	517,000	1,295,596
Të ardhura nga paga pranë Bashkisë V* Vlera 486,883 lekë.												429,832
Të ardhura nga ish Komuna B* si anëtar i Këshillit të Komunës, në periudhën nga dt. 28.6.2011 deri në 30.10.2014. Vlera 272,883 lekë							41,580	83,160	83,160	65,700		
Të ardhura nga I*Sh* P*, si kryetar i Dhomës Kombëtare, i Zgjidhjes së Konfliktëve, në periudhën 2010-2016. Vlera 772,000 lekë (shumuar nga union bank)								72,000	216,000	144,000	238,000	102,000
Të ardhura në total 1,078,418 lekë, për familjen bujqësore me kryefamiljar V* M* nga: (i) qira nga toka bujqësore, (ii) kompensim, (iii) servituf përfituar. Të ardhurat janë nga Shoqëria "T*", vlera 300,000 lekë.												215,684
Të ardhura të prishme nga kontrata e shijës së aksioneve zotit J* J*, sipas kontratës nr. *rep/kol dhe nr. *, datë 23.3.2016. Vlera 8,000,000 lekë.												
Të ardhura nga trashëgimia ligjore nga babai i personit të lidhur											200,000	
Të ardhura të bashkëjetësës krijuesit për blerje të bashkëjetësës							9,112,721					
Pasuritë e krijuara nga familjarët e subjektit në momentin e shpërblimit të subjektit prej tyre							58,023					
Të ardhura nga interesat e depozitave bankare pranë P* bank					7,599							
SHPENZIME	1,289,074	550,874	758,197	883,198	979,532	1,549,855	801,887	449,570	313,113	810,667	1,011,152	964,667
Shpenzime për mbledhje apartamenti						160,000	200,000	90,000		230,000		
Shpenzime për paketën e lindjes deklaruar në pyetjeor nr. 1 (2016-2017)												74,599
Shpenzime interesat për kredite			29,557	26,523	2,167							
Shpenzime për kredinë në A* bank							406,355	61,462				
Shpenzime udhëtimi	36,762	3,089	36,955	4,416	153,228	163,779	130,565	80,474	31,065	95,672	338,324	184,992
Shpenzime jetike	1,252,312	547,785	728,640	819,720	819,720	819,720	409,860	279,096	282,048	494,996	672,828	705,276
Analiza dokumentar	680,764	131,911	1,086,585	2,104,245	2,190,833	3,361,813	1,156,499	1,191,616	-2,009,550	-2,609,709	194,052	1,308,097

B. KONTROLLI I FIGURËS

56. AKSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, ky institucion ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017¹²³, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e ushtrimit të detyrës. Komisioni u ka kërkuar institucioneve ligjzbatuese sipas ligjit përditësim të informacionit mbi të dhëna shtesë për subjektin e rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, për sa kohë që raporti mbi kontrollin e figurës ishte deri më 2.11.2017. Nga verifikimet nuk kanë rezultuar të dhëna për hetime të mëtejshme.

57. Komisioni i ka kërkuar AKSIK-së përditësim të raportit¹²⁴ për vlerësimin e figurës për subjektin e rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, i cili në vijim ka përcjellë pranë Komisionit me shkresën nr. *** prot., datë 31.10.2023, raportin mbi kontrollin e figurës për këtë subjekt rivlerësimi të deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 24.10.2023, duke konstatuar: (i) se formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë, në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) se subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ajo në deklaratën për kontrollin e figurës, për të nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar; (iii) përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës.

58. Nga Prokuroria e Përgjithshme rezultoi se është regjistruar një kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit), për të cilin është disponuar me vendim për mosfillim të procedimit penal. Ky vendim mosfillimi është trajtuar tek seksioni “Vlerësimi i aftësive profesionale”, në nënçështjen “Të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime”.

59. Sipas informacionit të përcjellë nga SPAK-u, pas verifikimit të regjistrimit të njoftimit të veprave penale të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar¹²⁵ dhe të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, nuk rezultoi që në emër të subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku dhe personit të lidhur të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

60. Komisioni, në vijim, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucioneve të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi nuk u gjet ndonjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të kontrollit të figurës

61. Trupi gjykues, në kushtet që nga hetimi i kryer: (a) nuk konstatoi mangësi në lidhje me plotësimin e deklaratës së kontrollit të figurës apo vërtetësisë së të dhënave nga subjekti i rivlerësimit; (b) nuk u evidentuan rrethana që mund të përbënin indicie për kontakte të

¹²³ Me shkresën nr. *** prot., datë 25.10.2023 (administruar në Komision me nr. *** prot., datë 31.10.2023).

¹²⁴ Me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2023.

¹²⁵ Shkresat nr. *** prot., datë 9.3.2021 dhe *** prot., datë 27.6.2024.

papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit apo të mund të cenonin figurën e subjektit sipas dispozitave ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016; (c) nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës – çmon se subjekti i rivlerësimit znj. Ornela Rrumbullaku ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

62. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është përgatitur relacioni për vlerësimin e aftësive profesionale bazuar në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

63. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional për procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka hartuar dhe depozituar në Komision me shkresën nr. *** prot., datë 2.6.2023, raportin profesional për subjektin e rivlerësimit.

64. Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

65. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëvlerësimit profesional, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëvlerësimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të sektorit të burimeve njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të dhënat në drejtorinë ekonomike dhe të burimeve njerëzore pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

66. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, paraqet aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në aktet procedurale ligjore të paraqitura prej saj dhe në dosjet e vëzhguara sipas shortit, është konstatuar se subjekti ka identifikuar normën ligjore të zbatueshme në të gjitha rastet. Analizon normën penale dhe procedurale penale të zbatueshme, duke e harmonizuar atë me faktin penal apo rrethanat që përcaktojnë masën e dënimit.

b) Arsyetimi ligjor

Nga gjetjet në dokumentet ligjore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, rezultoi se subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet e marra dhe aktet e kryera prej saj kanë shtjellim të kuptueshëm. Organizon aktin në përputhje me standardet e pranuar për aktet përkatëse. Tregon kujdes që konkluzionet e saj të përfaqësojnë një lidhje koherente mes fakteve të parashtruara në akt dhe bazës ligjore të përdorur përgjatë arsyetimit.

Nga pikëpamja gjuhësore, respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit të përgatitur prej saj. Niveli i arsyetimit të akteve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

67. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, në periudhën e rivlerësimit ka hetuar gjithsej 202 procedime penale dhe materiale, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal. Ndërsa për vitin 2014 subjekti nuk ka pasur procedime penale të caktuara, pasi ka qenë në detyrën e drejtuesit të Prokurorisë e më pas me leje lindjeje. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti Ornela Rrumbullaku ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara në kohë dhe pa dëmtuar cilësinë e vendimmarrjes. Subjekti ka kryer detyrat e saj sipas urdhrit nr. 147 të Prokurorit të Përgjithshëm, datë 9.5.2008 “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë¹²⁶”.

Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, qëndrimi i saj është brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Analiza e të dhënave është bërë në referencë të ligjit procedural penal. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, subjekti i rivlerësimit ka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet. Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit Ornela Rrumbullaku është efikase dhe efektive.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit gjatë përpilimit të akteve ka treguar profesionalizëm për të kryer procedurat hetimore.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve hetimore të përzgjedhura me short, konstatohet se dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, ato na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe në disa raste me disponimin e gjykatës.

68. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Për periudhën e vlerësimit tetor 2013 – tetor 2016 ndaj subjektit nuk rezultoi marrja e ndonjë mase disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Ornela Rrumbullaku dhe nga pesë dosjet e vëzhguara sipas shortit, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak anësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të

¹²⁶ I.2, Ky urdhër përcakton: “Vendimi i mosfillimit të procedimit, vendimi i pushimit të çështjes, kërkesa për caktimin e masës së sigurimit personal, vendimi i zgjatjes së afatit të hetimeve, kërkesa për gjykimin e çështjes, konkluzionet përfundimtare dhe urdhrat në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale formulohen, arsyetohen dhe nënshkruhen nga prokurori i çështjes dhe detyrimin e prokurorit të çështjes për të diskutuar paraprakisht me Drejtuesin e Prokurorisë”.

grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

69. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në pesë dosjet e vëzhguara në format letër dhe në tri dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale dhe komunikimi i qartë e në përputhje me etikën e prokurorit.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e Prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit znj. Ornela Rrumbullaku rezultoi se i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Hetimi/analiza e kryer nga Komisioni

70. Pavarësisht raportit të dërguar, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre, në përfundim të hetimit, nga Komisioni nuk u konstatuan problematika dhe nuk u kërkuan shpjegime për dokumentet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe për dosjet e shortuara.

Vlerësimi i trupit gjykues

71. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

72. Të dhënat nga burimet arkivore

72.1 Nga verifikimi i të dhënave nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë, të burimeve arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme, si dhe të burimeve arkivore në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, për subjektin e rivlerësimit Ornela Rrumbullaku nuk rezultoi të ketë pasur masa disiplinore apo të jenë depozituar ndaj saj ankesa lidhur me punën e kryer.

72.2 Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme u gjetën 2 vlerësime të Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin Ornela Rrumbullaku, të cilat i përkasin punës së saj për vitet kalendarike 2015 dhe 2016, vlerësuar “shumë mirë”. Për vitin 2014, subjekti ka qenë në detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë e më pas me leje lindjeje. Nga subjekti janë paraqitur edhe vlerësimet e bëra për të nga Prokurori i Përgjithshëm për vitet 2012, 2013, 2014, të cilat kanë vlerësimin “shumë mirë”.

72.3 Nga Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. *** prot., datë 9.6.2021, u konfirmua se në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan rezultoi të jetë regjistruar kallëzimi penal drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet të cilit kallëzuesi Dritan Gina akuzon prokuroren Ornela Rrumbullaku, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë dhe shtetasin A.M, bashkëshorti i saj, për kryerjen e veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal “Fshehja e të ardhurave”, parashikuar nga neni 180 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal: “*Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë, interesave privatë të personit të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo*

personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a, paragrafi II i Kodit Penal.

72.4 Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan u konfirmua se për rastin në datën 22.6.2018 është vendosur mosfillimi i procedimit penal për materialin hetimor nr. *** regj., datë 7.6.2018, që bën fjalë për kallëzimin e shtetasit D.G, me arsyetimin se mungojnë elementet e veprës penale të parashikuara nga nenet 180, 248, 257/a dhe 287 të Kodit Penal. Ky vendim është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan (sot Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan) nga ankuesi D.G.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin gjyqësor nr. (***) ***, datë 23.10.2019, ka vendosur rrëzimin e ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit të mosfillimit të procedimit penal, datë 22.6.2018, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Vendimi i shkallës së parë është ankimuar në Gjykatën e Apelit Durrës, e cila me vendimin e saj nr. ***/***, datë 11.9.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit penal nr. (***) ***, datë 23.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

73. DENONCIME/ANKESA

73.1 Ndaj subjektit të rivlerësimit janë regjistruar gjithsej 16 (gjashtëmbëdhjetë) denoncime, nga këto disa prej tyre janë përsëritëse. Referuar nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoj shpjegime për 1 denoncim, si vijon:

73.2 Nga verifikimi i denoncimit nr. *** prot., datë 26.3.2018 dhe i materialit bashkëlidhur, shtetasi B.B pretendon se prokurorja Ornella Rrumbullaku qëllimisht nuk hetoi thellë dosjen e tij, megjithëse duheshin 3 muaj që të arrinte afati i parashkrimit të veprës penale (afati 5-vjeçar). Sipas denoncuesit, subjekti qëllimisht nuk hetoi brenda afatit 3-mujor dhe mori vendim pushimi, pasi noteri N.M ishte person në kërkim e kështu nuk mund të hetonte në bazë të nenit 248 të Kodit Penal për veprën “Shpërdorimi i detyrës”, si dhe nuk hetoi as origjinën e dyshimtë të kapitalit të administratorëve të shoqërisë “****” sh.p.k. Në denoncim, ky shtetas shprehet ndër të tjera se prokurori i çështjes duhet të ndiqte penalisht për “shpërdorim detyre” për mosveprim policin OPGJ H.C, pasi sipas tij ndaj OPGJ-së nuk u mor as masë disiplinore nga SHKB-ja në Ministrinë e Brendshme.

Hetimi/analiza e kryer nga Komisioni

73.3 Nga hetimi rezultoi se ndaj shtetasit H.B, babait të shtetasit (denoncuesit) B.B, është marrë vendimi për pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. *** nga subjekti Ornella Rrumbullaku¹²⁷. Në vendimin e pushimit të hetimeve, subjekti i rivlerësimit arsyeton se vepra penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal, është parashkruar, pasi ka kaluar afati 5-vjeçar dhe në bazë të nenit 66/c të Kodit Penal nuk mund të ushtrohet ndjekje penale ndaj një personi kur kanë kaluar 5 vjet nga kryerja e veprës penale deri në momentin e marrjes së tij në cilësinë e të pandehurit. Në këto kushte, nuk mund të ushtrohet ndjekje penale ndaj shtetasve S.B dhe S.B. Në lidhje me hartimin e kontratës objekt hetimi para noterit N.M, subjekti arsyeton se në rastin konkret është e pamundur të konkludohet nëse jemi para veprës penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal apo para veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal. Kjo për faktin se është i domosdoshëm administrimi i praktikës dokumentare të mbajtur nga noteri N.M për hartimin e kësaj kontrate, por nga sistemi TIMS rezulton se shtetasi N.M është larguar nga Shqipëria në datën 24.5.2008 dhe është në kërkim për shkak të një vendimi dënimi me burg nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në kushtet kur arkivi i noterit M i kishte kaluar noteres I. B, nga prokuroria është kërkuar pranë zyrës së kësaj të fundit praktika, por nga

¹²⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 25.4.2024.

procesverbali përkatës i mbajtur për rastin ka rezultuar se kjo notere nuk ka marrë në dorëzim praktikat objekt hetimi. Në këto kushte, subjekti arrin në konkluzionin se nuk mund të dilet në përfundimin nëse nga ana e noterit janë konsumuar elementet e veprës penale të parashikuara nga neni 248 apo nga neni 186/e i Kodit Penal. Kjo për faktin se vepra penale e parashikuar nga neni 246 i Kodit Penal është parashkruar, ndërsa vepra penale e parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal nuk është parashkruar, por nga provat e administruara nuk mund të konkludohet nëse me veprimet e tij noteri N.M ka konsumuar elementet e veprës penale të falsifikimit të dokumenteve nga personat që kanë për detyrë të lëshojnë dokumentin ose jo. Në përfundim të hetimit, subjekti Ornela Rrumbullaku, bazuar në nenin 328/1, shkronja “d”, “dh” të Kodit të Procedurës Civile, ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. ***, viti 2009. Bazuar në nenin 190/1 të Kodit të Procedurës Penale, deklarohet i falsifikuar dokumenti – kontratë e pjesëtimit vullnetar nr. ***, datë 22.9.2004, hartuar nga noteri N.M dhe ky dokument qëndron në fashikullin e procedimit penal.

73.4 Komisioni hetoi nëse vendimi sa më sipër i marrë nga subjekti i rivlerësimit për pushimin e gjykimit ishte ankimuar në gjykatë. Nga gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,¹²⁸ dhe nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë,¹²⁹ u konfirmua se për periudhën nga viti 2009 e deri më tani, nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë çështje penale me kërkues H.B, me objekt “Kundërshtim vendimi pushimi të procedimit penal nr. ***/2009” të prokurores Ornela Rrumbullaku. Kjo tregon se shtetasi H.B nuk e ka ushtruar të drejtën e tij ligjore për të bërë ankim ndaj vendimit të pushimit të hetimeve të vitit 2009.

73.5 Nga hetimi rezultoi se në lidhje me pretendimin e denoncuesit për tejkalimin e afatit 3-mujor, nga aktet e marra pranë Prokurorisë rezultoi se në dosjen penale për rastin nuk kishte një kërkesë nga prokurori i çështjes dhe vendim për zgjatje të afatit të hetimeve (parashikuar në nenet 323 - 324 të Kodit të Procedurës Penale të kohës dhe aktet e Prokurorit të Përgjithshëm). Bazuar në aktet e dosjes penale, subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar afatin e parashikuar në dispozitat ligjore për rastin¹³⁰. Në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit.

73.6 Subjekti i rivlerësimit pas dhënies së shpjegimeve dhe gjatë seancës dëgjimore sqaroi se: *“1. ...Konstatohet se vetë denoncuesi B.B është paraqitur në Drejtorinë Vendore të Policisë T, pranë Krimin Ekonomik, në datën 14 korrik 2009, ku i është marrë kallëzim penal me shkrim nga oficeri i policisë gjyqësore, H.C. 2. Nga ana tjetër, për sa i përket afatit hetimor, vlerësoj se në kushtet që materiali kallëzues mban datën 15.7.2009, kam pasur në dispozicion afatin në maksimumin 20 ditë¹³¹, por në kushtet kur në vijim ka qenë muaji gusht, i cili për sistemin gjyqësor është pushim, është bërë regjistrimi i procedimit penal në datën 1.9.2009, menjëherë pas lejes vjetore. 3. Për sa i përket faktit se nuk është respektuar afati 3-mujor i hetimeve sipas nenit 323 të Kodit të Procedurës Penale, sqaroj si më poshtë: 1. Në udhëzimin nr. 241, datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar, është parashikuar se: 3.1. Në rastet e kallëzimeve, fillimisht regjistrohet njoftimi për veprën penale, nëse janë kushtet e pikës 2. Pasi administrohen aktet*

¹²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 3.6.2024.

¹²⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2024.s

¹³⁰ Neni 323 (Afati i hetimeve paraprake). Neni 324 [(Zgjatja e afatit) (Shtuar një paragraf në pikën 2 me ligjin nr. 8460, datë 11.2.1999)]. Udhëzimi nr. 2, datë 27.10.2006, pika 2.2 “Afati i verifikimit të kallëzimit penal është deri në 20 ditë”. Udhëzimi nr. 3, datë 8.3.2007, i Prokurorit të Përgjithshëm “Hetimet paraprake duhet të përfundojnë brenda 3 muajve nga data në të cilën emri i personit që i atribuohet vepra penale është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprës”.

¹³¹ 2.2 Në rastet e veçanta, kur me gjithë verifikimet e kryera në afatin e përcaktuar në pikën 2.1, të sipërpërmendur, prokurori vlerëson se është e domosdoshme të kryhen verifikime të tjera për ekzistencën e elementeve thelbësore të faktit dhe/ose të elementeve të figurës së veprës penale, afati i verifikimit të kallëzimit penal dhe/ose njoftimit të veprës penale të marrë me iniciativën e tij, të jetë në maksimum deri në 20 ditë (udhëzimi nr. 241 datë 21.11.2005 “Për regjistrimin e njoftimit të veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale”, i ndryshuar).

*procedurale që i atribuojnë kryerjen e veprës penale personit, prokurori merr vendim për regjistrimin e emrit. Përmendja e emrit të një personi në një kallëzim nuk mund të shërbejë për regjistrimin e menjëhershëm të emrit në regjistër, pa u administruar më parë aktet procedurale, në të cilat gjenden atribuime për personin konkret. 2. Kjo tregon se pavarësisht se kallëzimi penal ishte drejtuar për persona konkretë, prokurori ka diskrecionin që të bëjë regjistrimin e emrit të personit në momentin që ka prova të mjaftueshme për atribuimin e faktit penal personit të caktuar. Prokurori nuk mund të bëjë menjëherë regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, pa kryer më parë veprimet hetimore minimale që provojnë ekzistencën e faktit penal, që në rastin konkret fillimisht të sekuestrohej dokumenti origjinal, për të cilin pretendohej se ishte i falsifikuar dhe, më pas, kryerja e aktit të ekspertimit teknik të dokumentit. 3. Nga ana ime si prokuror i çështjes, këto detyra i janë deleguar me urdhrin e delegimit të datës 20.9.2009 oficerit të policisë gjyqësore, L. K. Nga dosja rezulton se oficerja e policisë gjyqësore ka kryer veprimet hetimore dhe vetëm pas përfundimit të tyre ka përpiluar relacionin për kryerjen e veprimeve hetimore dhe sugjerimin për përfundimin e hetimeve. Pasi jam njohur me relacionin, kam konstatuar se vepra penale për të cilën ishte regjistruar procedimi penal, ishte parashkuar dhe, për këtë shkak, kam vendosur pushimin e procedimit penal, por njëkohësisht kam konstatuar edhe falsitetin e dokumentit objekt hetimi dhe kam njoftuar Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për këtë vendim. 4. ...Denoncuesi B. B, ndonëse është vënë në dijeni për këtë vendim në vitin 2010, me shkresën nr. *** prot., datë 1.3.2010, nuk ka bërë ankim ndaj këtij vendimi, me qëllim që të parashtronte mosdakordësinë me këtë vendim, por vetëm në vitin 2018 ka depozituar ankesë pranë KPK-së, gjë që tregon se në parim ka qenë dakord me këtë vendimmarrje, por problematika ka qëndruar tek ai vetë, që ka depozituar kallëzimin penal në limitet e parashkrimit të ndjekjes penale (ndonëse faktin penal e ka ditur vite më parë), duke mos i dhënë kohën e duhur organit të akuzës për të provuar ekzistencën e faktit penal dhe njëkohësisht për të ngritur akuzë brenda afateve ligjore që na lejon ligji.”*

Vlerësimi i trupit gjykues

73.7 Në analizë të fakteve dhe provave, shpjegimeve të dhëna nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit, trupi gjykues arrin në konkluzionin se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në mënyrë bindëse dhe në nivel ligjor mbi gjetjet e evidentuara sa më sipër në trajtimin e denoncimit të depozituar nga publiku.

Konkluzion për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

74. Komisioni, pas verifikimit dhe analizimit në mënyrë të pavarur të tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, trupi gjykues vlerësoi se nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 72 i ligjit nr. 96/2016.

75. Me anë të prapësimeve të depozituara, si dhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegimet/argumentet e saj, si dhe ka depozituar dokumentacion provues në mbështetje të tyre, për kërkesat e bëra dhe problematikat e ngritura nga Komisioni në trajtimin e denoncimeve të depozituara nga publiku.

76. Bazuar në ligjin nr. 84/2016, nga analiza në tërësi e kriterit të aftësive profesionale, trupi gjykues nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, referuar nenit Ç, D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, në bindjen e brendshme, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, çmon se referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel kualifikues, pasi ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; si dhe në bazë të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, të cilat përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, aktualisht prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 4.9.2024.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Pamela QIRKO
Kryesuese

Alma FASKAJ
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Albana Plaka